FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 161 — 18 dhjetor — 2012

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Dekret nr.7852 datë 7.12.2012	Për dhënie të shtetësisë shqiptare……	8659
Akt normativ i KM nr. 6, datë 12.12.2012	Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 487, datë 5.12.2011 "Për buxhetin e vitit 2012"……	8659
Udhëzim i MB nr. 370, datë 7.12.2012	Për procedurat e pastrimit të dublimeve të shtetasve shqiptarë nga regjistrat themeltarë dhe Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile……	8669
Vendim i GJK nr. 52, datë 5.12.2012	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën, të ligjit nr.8662, datë 18.09.2000 "Për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës së konsumit të energjisë elektrike", ndryshuar me ligjin nr.8735, datë 01.02.2001 "Për një shtesë në ligjin nr.8662, datë 18.09.2000 'Për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës së konsumit të energjisë elektrike'", i shtuar me ligjin nr.10486, datë 26.11.2011 "Për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës së konsumit të energjisë elektrike"……	8679
Vendim i GJK nr. 53, datë 5.12.2012	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën, të vendimeve: nr.59, datë 11.06.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gramsh; nr.30, datë 27.03.2008 të Gjykatës së Apelit Durrës; nr.00-2010-462 (374), datë 23.04.2010 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë……	8687

DEKRET
Nr.7852, datë 7.12.2012

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika "c", dhe 93 të Kushtetutës, si dhe neneve 9, 10 dhe 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Enis Hilmi Kamberi
2. Gjyltene Avdi Vladi (Rexhepi)
3. Makbule Arif Zeytinoğlu (Kanay)
4. Mahmoud Taha Mahmoud Shehata
5. Ismet Ramadan Rexhaj
6. Hüseyin Cemal Yavuz
7. Duygu Mahmut Yavuz
8. Ahmet Hasan Ertaş
9. Ferhan Hasan Gökdemir
10. Rana Erva Yusuf Gökdemir
11. Syzana Veli Zeqiri (Xhaka)
12. Emmanuel Delphin Etienne Assako Ella
13. Alberto Innocenzo Carlini
14. Pren Nue Bezhi
15. Muja Shabi Shabija

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

AKT NORMATIV
Nr. 6, datë 12.12.2012

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.10487, DATË 5.12.2011
"PËR BUXHETIN E VITIT 2012"

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në ligjin nr.10487, datë 5.12.2011, "Për buxhetin e vitit 2012", bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Neni 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Neni 1

Buxheti për vitin 2012 është:

Të ardhurat	332 758	milionë lekë;
Shpenzimet	382 296	milionë lekë;
Deficiti	49 538	milionë lekë.

Ai përbëhet nga buxheti i shtetit, buxheti vendor dhe fondet speciale: sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore dhe kompensimi i pronarëve.".

Neni 2

Neni 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Neni 2

Buxheti i shtetit për vitin 2012 është:

Të ardhurat	263 172	milionë lekë;
Shpenzimet	312 710	milionë lekë;
Deficiti	49 538	milionë lekë.".

Neni 3

Neni 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Neni 3

Buxheti vendor për vitin 2012 është:

Të ardhurat	27 049	milionë lekë;
Nga të cilat:		
Granti i pakushtëzuar nga buxheti qendror	13 876	milionë lekë;
Të ardhurat	13 173	milionë lekë;
Shpenzimet	27 049	milionë lekë.".

Neni 4

Neni 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Neni 4

Buxheti i sigurimeve shoqërore për vitin 2012 është:

l. Skema e sigurimit të detyrueshëm shoqëror

Të ardhurat, gjithsej	83 360	milionë lekë;

Nga të cilat:

- kontributet	50 287	milionë lekë;
- transferimet nga buxheti i shtetit	33 073	milionë lekë;
- shpenzimet	83 360	milionë lekë.

Paga minimale, për efekt të pagesës së kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, përcaktohet nga Këshilli i Ministrave dhe ndryshon sa herë që rriten pagat dhe pensionet. Këshilli i Ministrave ka të drejtë të përcaktojë një kontribut të veçantë minimal për personat e vetëpunësuar në bujqësi dhe për kategoritë specifike të personave të vetëpunësuar. Diferenca ndërmjet kontributeve të veçanta me kontributin minimal mbulohet nga transferta e buxhetit të shtetit, por jo më shumë se kufijtë e transfertave të përcaktuara në këtë ligj. Për vitin 2012, teprica e të ardhurave, sipas degëve të sigurimit shoqëror, përdoret për mbulimin e deficitit të degës së pensioneve.

2. Skema e sigurimit suplementar

Të ardhurat, gjithsej	5 405	milionë lekë;

Nga të cilat:

- kontributet	290	milionë lekë;
- transferimet nga buxheti i shtetit	5 115	milionë lekë;
- shpenzimet	5 405	milionë lekë.".

Neni 5

Neni 8 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Neni 8

Të ardhurat e buxhetit të shtetit, sipas grupeve kryesore, janë:

Grantet	4 020	milionë lekë;
Të ardhurat tatimore	235 922	milionë lekë;
Të ardhurat jotatimore	23 230	milionë lekë.".

Neni 6

Neni 9 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Neni 9

Kufiri i financimit të deficitit të buxhetit të shtetit nga burime të brendshme dhe të huaja është 49 538 milionë lekë, nga i cili 900 milionë lekë financohen nga të ardhurat e privatizimit. Në rast mosrealizimi të të ardhurave të buxhetit dhe të të ardhurave nga privatizimi, huamarrja totale për financimin e deficitit prej 48 638 milionë lekësh nuk ndryshon. Këshilli i Ministrave merr masa për kompensimin e diferencave nga burime suplementare ose nga shkurtimi i shpenzimeve.

Çdo e ardhur nga privatizimi, e arkëtuar mbi shumën e parashikuar në këtë ligj, përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave për rritjen e kufirit të shpenzimeve për investime dhe uljen e huamarrjes, e cila, automatikisht, rrit kufirin e deficitit të buxhetit të shtetit, të përcaktuar në nenet 1 dhe 2 të këtij ligji.".

Neni 7

Neni 10 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Neni 10

Shpenzimet e buxhetit të shtetit, sipas grupeve kryesore, janë:

Shpenzimet korente	241 365	milionë lekë;
Shpenzimet kapitale	64 690	milionë lekë;
Fondi rezervë	1 800	milionë lekë;
Fondi i kontingjencës për ruajtjen e deficitit	2 600	milionë lekë;
Fondi për rritjen e pagave dhe pensioneve	2 255	milionë lekë.

Kufiri i shpenzimeve për çdo ministri dhe institucion, në nivel programi, është sipas tabelës 1, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Këshilli i Ministrave vendos norma dhe standarde financiare për shpenzimet publike, të cilat janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme.

Gjendja e mjeteve monetare, që do të rezultojë në fund të vitit buxhetor në llogarinë unike të thesarit, si rezultat i mosrealizimit të shpenzimeve ose tejkalimit të të ardhurave, të transferohet në llogarinë e shpronësimeve për interesa publikë.".

Neni 8

Në nenin 11, shuma e fondit të veçantë, prej 1931 milionë lekësh, ndryshohet në 1145 milionë lekë.

Neni 9

Neni 13 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Neni 13

Fondi rezervë i Këshillit të Ministrave, prej 1 800 milionë lekësh, përdoret për raste të paparashikuara të institucioneve buxhetore. Fondi i kontingjencës për ruajtjen e deficitit, prej 2 600

milionë lekësh, përdoret me vendime të Këshillit të Ministrave. Fondi për rritjen e pagave e të pensioneve, prej 2 255milionë lekësh, shpërndahet nga ministri i Financave, sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 10

Neni 18 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 18

Kufiri për rritjen vjetore të totalit ekzistues të borxhit të shtetit dhe atij të garantuar të shtetit, në dobi të palëve të treta përfituese, për vitin 2012, është 87,740 milionë milionë lekë, i dhënë me hollësi si më poshtë:

1. Për huamarrjen vjetore neto, për mbështetjen buxhetore, deri në 26,290 milionë lekë.

2. Për huamarrjen neto, për financimin e projekteve të huaja, deri në 46,000 milionë lekë.

Për rritjen vjetore të garancive të shtetit, në dobi të palëve të treta përfituese, deri në 13,700 milionë lekë.

3. Kufiri për rritjen vjetore të stokut të borxhit, si rezultat i riskedulimit të borxheve të vjetra të huaja, të papaguara, deri në 1,750 milionë lekë.

4. Niveli i stokut të borxhit shtetëror parashikohet të arrijë deri në 792,694 milionë lekë, ndërsa niveli i stokut të garancive deri në 62,683 milionë lekë.”.

Neni 11

Ngarkohet Ministria e Financave të nxjerrë udhëzime për zbatimin e këtij ligji.

Neni 12

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

AKTI NORMATIV I VITIT 2012 SIPAS MINISTRIVE TË LINJËS DHE INSTITUCIONEVE BUXHETORE

në 000/lekë

Kodi	Emërtimi i iInstitucionit / programit	Totali i shpenzimev e Korrente	Shpenzimet Kapitale			Totali i shpenzimev e kapitale	Totali i shpenzimev e buxhetore
			Nga buxheti	Nga të ardhurat	Financimi i huaj		
1	**Presidenca**	**143,750**	**15,000**	**0**	**0**	**15,000**	**158,750**
01120	Veprimtaria e Presidentit	143,750	15,000	0	0	15,000	158,750
2	**Kuvendi**	**808,000**	**156,000**	**0**	**0**	**156,000**	**964,000**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	808,000	156,000	0	0	156,000	964,000
3	**Keshilli Ministrave**	**372,313**	**20,000**	**0**	**0**	**20,000**	**392,313**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	354,664	20,000	0	0	20,000	374,664
01140	Teknologjia e Informacionit dhe Komununikimeve Elektronike dhe Postare	17,649	0	0	0	0	17,649
4	**Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes**	**1,021,875**	**281,961**	**0**	**2,150,000**	**2,431,961**	**3,453,836**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	287,435	50,671	0	0	50,671	338,106
04320	Mbështetje për energjinë	10,875	30,000	0	100,000	130,000	140,875
04430	Mbështetje për burimet natyrore	187,406	101,250	0	100,000	201,250	388,656
04130	Mbështetje për zhvillim ekonomik	236,095	58,000	0	1,750,000	1,808,000	2,044,095
04160	Mbështetje për mbikqyrjen e tregut, infrast. e ciles. dhe pronësinë industriale	300,064	42,040	0	200,000	242,040	542,104
04770	Mbështetje për zhvillim rajonal	0	0	0	0	0	0
5	**Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit**	**3,673,869**	**1,328,424**	**0**	**715,000**	**2,043,424**	**5,717,293**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	226,470	4,960	0	0	4,960	231,430
04220	Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit	1,243,147	70,500	0	250,000	320,500	1,563,647
04240	Menaxhimi i infrastrukturës se kullimit dhe ujitjes	760,776	1,128,800	0	100,000	1,228,800	1,989,576
04250	Zhvillimi rural duke mbesht. prodh. bujq, blek, agroind dhe market.	1,234,963	90,460	0	365,000	455,460	1,690,423
04860	Këshillimi dhe Informacioni Bujqësor	200,773	33,704	0	0	33,704	234,477
05470	Menaxhimi qëndrueshëm i tokës bujqësore	7,740	0	0	0	0	7,740
6	**Ministria e Punëve Publike dhe Transportit**	**3,693,769**	**12,474,448**	**0**	**22,317,711**	**34,792,159**	**38,485,928**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	297,300	3,000	0	0	3,000	300,300
04520	Rrjeti i rrugëve nacionale	1,246,060	8,926,695	0	17,116,300	26,042,995	27,289,055
04530	Menaxhimi i transportit	21,345	0	0	0	0	21,345
04540	Portet	71,795	275,544	0	760,000	1,035,544	1,107,339
04550	Hekurudhat	461,386	70,000	0	0	70,000	531,386
04560	Aviacioni civil	21,790	12,000	0	0	12,000	33,790
06370	Ujësjellës-kanalizime	717,802	2,948,040	0	3,488,713	6,436,753	7,154,555
06180	Strehimi dhe urbanistika	675,144	153,727	0	872,698	1,026,425	1,701,569
06220	Shërbimet publike	181,147	85,442	0	80,000	165,442	346,589
10	**Ministria e Financave**	**5,969,294**	**483,977**	**0**	**298,582**	**782,559**	**6,751,853**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	233,775	162,600	0	82,582	245,182	478,957
01120	Menaxhimi i shpenzimeve publike	482,375	3,000	0	0	3,000	485,375
01130	Ekzekutimi i pagesave te ndryshme	107,600	0	0	0	0	107,600
01140	Menaxhimi i te ardhurave tatimore	1,935,878	91,200	0	0	91,200	2,027,078
01150	Menaxhimi i te ardhurave doganore	1,357,072	144,177	0	16,000	160,177	1,517,249
01160	Lufta kunder transaksioneve financiare jo-ligjore	52,594	3,000	0	0	3,000	55,594
10270	Menaxhimi i Sigurimeve Shoqerore	1,800,000	80,000	0	200,000	280,000	2,080,000
11	**Ministria e Arsimit dhe Shkencës**	**34,221,434**	**2,401,918**	**0**	**1,649,598**	**4,051,516**	**38,272,950**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	686,100	62,739	0	45,900	108,639	794,739
09120	Arsimi bazë (përfshirë parashkollorin)	21,459,610	1,068,060	0	1,052,990	2,121,050	23,580,660
09230	Arsimi i mesëm (i përgjithshëm)	4,473,354	430,460	0	347,025	777,485	5,250,839
09240	Arsimi i mesëm (profesional)	1,794,681	294,742	0	90,000	384,742	2,179,423
09450	Arsimi universitar	5,484,451	545,917	0	113,683	659,600	6,144,051
09770	Fonde për shkencën	323,238	0	0	0	0	323,238
12	**Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve**	**1,419,053**	**331,627**	**0**	**50,000**	**381,627**	**1,800,680**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	141,965	2,500	0	0	2,500	144,465
08220	Trashëgimia kulturore dhe muzetë	314,857	201,612	0	50,000	251,612	566,469
08230	Arti dhe kultura	593,956	65,479	0	0	65,479	659,435
08140	Zhvillimi i sportit	141,911	61,536	0	0	61,536	203,447
08170	Programe për rininë	8,693	0	0	0	0	8,693
04760	Zhvillimi i turizmit	101,914	0	0	0	0	101,914
08480	Mbështetje për Kultet Fetare	115,757	500	0	0	500	116,257
13	**Ministria e Shëndetësisë**	**26,209,281**	**1,620,927**	**15,000**	**1,645,000**	**3,280,927**	**29,490,208**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	217,400	3,380	0	0	3,380	220,780
07220	Shërbimet e kujdesit parësor	9,191,550	219,191	3,000	635,000	857,191	10,048,741
07330	Shërbimet e kujdesit dytësor	14,447,951	1,366,776	10,000	1,010,000	2,386,776	16,834,727
07450	Shërbimet e shëndetit publik	2,352,380	31,580	2,000	0	33,580	2,385,960

në 000/lekë

Kodi	Emërtimi i institucionit / programit	Totali i shp. korrente	Shpenzimet kapitale				Totali i shpenzimeve buxhetore
			NgaBuxheti	Nga te ardhurat	Financimi i huaj	Totali i shp. sapitale	
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	288,763	86,380	0	0	86,380	375,143
01120	Publikimet Zyrtare	51,477	1,000	0	0	1,000	52,477
01130	Mjekësia Ligjore	41,440	4,000	0	0	4,000	45,440
03440	Sistemi i Burgjeve	3,334,656	357,980	0	100,000	457,980	3,792,636
03350	Shërbimi i Përmbarimit Gjyqësor	101,500	1,000	0	0	1,000	102,500
01160	Shërbimet për çështjet e birësimeve	11,455	500	0	0	500	11,955
01170	Shërbimi i Regjistrimit të Pasurive te Paluajtshme	475,050	8,000	0	350,000	358,000	833,050
01180	Shërbimi i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave	414,960	1,960	0	0	1,960	416,920
03490	Shërbimi i Provës	62,500	2,500	0	0	2,500	65,000
01190	Rehabilitimi i të Përndjekurve Politik	24,900	1,000	0	0	1,000	25,900
15	**Ministria e Punëve të Jashtme**	**1,940,855**	**74,000**	**0**	**0**	**74,000**	**2,014,855**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	87,255	4,000	0	0	4,000	91,255
01120	Mbështetje diplomatike jashtë shtetit	1,622,891	70,000	0	0	70,000	1,692,891
01130	Aktiviteti diplomatik dhe konsullor i MPJ	230,709	0	0	0	0	230,709
16	**Ministria e Brendshme**	**14,626,133**	**838,000**	**0**	**960,000**	**1,798,000**	**16,424,133**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	730,783	70,000	0	0	70,000	800,783
01330	Menaxhimi dhe Zhvillimi i Administratës Publike	68,979	0	0	0	0	68,979
03140	Policia e Shtetit	10,864,666	425,130	0	530,000	955,130	11,819,796
03150	Garda e Republikës	1,126,700	25,000	0	0	25,000	1,151,700
01160	Prefekturat dhe Funksionet e Deleguara te P. Vendor	518,100	3,500	0	0	3,500	521,600
01170	Shërbimi i Gjendjes Civile	534,550	40,000	0	0	40,000	574,550
01180	Menaxhimi i Rezervave te Shtetit	89,755	1,400	0	0	1,400	91,155
10910	Emergjencat Civile	692,600	272,970	0	430,000	702,970	1,395,570
17	**Ministria e Mbrojtjes**	**16,530,245**	**3,000,000**	**0**	**0**	**3,000,000**	**19,530,245**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	1,153,315	0	0	0	0	1,153,315
02120	Forcat e Luftimit	4,906,612	2,871,900	0	0	2,871,900	7,778,512
09430	Arsimi Ushtarak	791,540	98,100	0	0	98,100	889,640
07340	Mbështetje Shëndetësore	646,570	0	0	0	0	646,570
02150	Mbështetja e Luftimit	3,830,298	30,000	0	0	30,000	3,860,298
10270	Mbështetje Sociale për Ushtarakët	4,500,000	0	0	0	0	4,500,000
02280	Bashkëpunimi Civilo - Ushtarak (AL-CIMIC)	701,910	0	0	0	0	701,910
18	**Shërbimi Informativ Shtetëror**	**1,156,000**	**80,000**	**0**	**0**	**80,000**	**1,236,000**
03520	Veprimtaria Informative Shtetërore	1,156,000	80,000	0	0	80,000	1,236,000
19	**Drejtoria e Radio-Televizionit**	**352,000**	**50,000**	**0**	**0**	**50,000**	**402,000**
08310	Shërbimet për shqiptaret jashtë kufirit	252,000	0	0	0	0	252,000
08520	Projekte teknike për futjen e teknologjive të reja	0	50,000	0	0	50,000	50,000
08330	Prodhime filmike ose veprimtari artistike mbarëkombëtare	55,000	0	0	0	0	55,000
08340	Orkestra simfonike e RTSH dhe kinematografisë	45,000	0	0	0	0	45,000
20	**Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave**	**154,021**	**3,500**	**0**	**0**	**3,500**	**157,521**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	154,021	3,500	0	0	3,500	157,521
22	**Akademia e Shkencës**	**76,159**	**1,000**	**0**	**0**	**1,000**	**77,159**
01520	Veprimtaria Akademike	76,159	1,000	0	0	1,000	77,159
24	**Kontrolli Lartë i Shtetit**	**255,086**	**5,000**	**0**	**0**	**5,000**	**260,086**
01120	Veprimtaria Audituese e KLSH	255,086	5,000	0	0	5,000	260,086
25	**Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta**	**54,369,359**	**122,352**	**8,000**	**20,000**	**150,352**	**54,519,711**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	137,894	24,000	0	0	24,000	161,894
10220	Sigurimi Shoqëror	31,893,741	0	0	0	0	31,893,741
10430	Mbrojtja Sociale	20,623,984	65,100	0	0	65,100	20,689,084
10550	Tregu i Punës	1,536,391	30,000	8,000	20,000	58,000	1,594,391
04170	Inspektimi ne Pune	155,281	2,252	0	0	2,252	157,533
10460	Shanset e Barabarta	22,070	1,000	0	0	1,000	23,070
26	**Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujërave**	**1,076,686**	**225,000**	**0**	**254,000**	**479,000**	**1,555,686**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	90,166	2,000	0	0	2,000	92,166
05320	Programe për mbrojtjen e Mjedisit	222,765	77,000	0	204,000	281,000	503,765
04230	Mbështetje për Peshkimin	72,569	96,000	0	50,000	146,000	218,569
05640	Administrimi i Ujërave	47,648	0	0	0	0	47,648
04260	Administrimi i Pyjeve	643,538	50,000	0	0	50,000	693,538
28	**Prokuroria e Përgjithshme**	**1,213,722**	**59,000**	**0**	**0**	**59,000**	**1,272,722**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	1,213,722	59,000	0	0	59,000	1,272,722

në 000/lekë

Kodi	Emërtimi i institucionit / programit	Totali i Shp. Korrente	Shpenzimet Kapitale				Totali i Shpenzimeve Buxhetore
			Nga Buxheti	Nga te Ardhurat	Financimi i Huaj	Totali i Shp. Kapitale	
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	20,645	500	0	0	500	21,145
03310	Buxheti Gjyqësor	1,530,689	179,500	0	0	179,500	1,710,189
30	**Gjykata Kushtetuese**	**102,328**	**4,000**	**0**	**0**	**4,000**	**106,328**
03320	Veprimtaria Gjyqësore Kushtetuese	102,328	4,000	0	0	4,000	106,328
31	**Agjencia Telegrafike Shqiptare**	**85,427**	**3,000**	**0**	**0**	**3,000**	**88,427**
08320	Veprimtaria Telegrafike e ATSH-se	85,427	3,000	0	0	3,000	88,427
40	**Partitë Politike**	**200,000**	**0**	**0**	**0**	**0**	**200,000**
01110	Mbështetje për Partitë Politike	189,000	0	0	0	0	189,000
01120	Mbështetje për Shoqatat	9,000	0	0	0	0	9,000
01130	Mbështetje për Organizatat e Veteraneve me Status	2,000	0	0	0	0	2,000
50	**Instituti Statistikës**	**375,640**	**30,000**	**0**	**150,000**	**180,000**	**555,640**
01320	Veprimtaria Statistikore	375,640	30,000	0	150,000	180,000	555,640
55	**Shkolla e Magjistraturës**	**53,489**	**2,000**	**0**	**0**	**2,000**	**55,489**
09820	Veprimtaria Arsimore	53,489	2,000	0	0	2,000	55,489
56	**Fondi i Zhvillimit Shqiptar**	**0**	**1,500,000**	**0**	**6,831,000**	**8,331,000**	**8,331,000**
06210	Programe Zhvillimi	0	1,500,000	0	6,831,000	8,331,000	8,331,000
57	**Qendra Kombëtare e Kinematografisë**	**100,696**	**2,000**	**0**	**0**	**2,000**	**102,696**
08220	Mbështetja e veprimtarisë kinematografike	100,696	2,000	0	0	2,000	102,696
63	**Këshilli i Lartë i Drejtësisë**	**75,205**	**3,000**	**0**	**0**	**3,000**	**78,205**
03320	Veprimtaria mbikëqyrëse e KLD	75,205	3,000	0	0	3,000	78,205
66	**Avokati i Popullit**	**78,711**	**1,500**	**0**	**0**	**1,500**	**80,211**
03320	Shërbimi i avokatisë	78,711	1,500	0	0	1,500	80,211
67	**Komisioni i Shërbimit Civil**	**35,663**	**2,000**	**0**	**0**	**2,000**	**37,663**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	35,663	2,000	0	0	2,000	37,663
73	**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**	**83,906**	**3,000**	**0**	**0**	**3,000**	**86,906**
01610	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	83,906	3,000	0	0	3,000	86,906
01620	Zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale	0	0	0	0	0	0
76	**Inspektorati i Lartë i Kontrollit të Deklarimit të Pasurive**	**79,120**	**4,000**	**0**	**0**	**4,000**	**83,120**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	79,120	4,000	0	0	4,000	83,120
77	**Autoriteti i Konkurrencës**	**53,726**	**2,000**	**0**	**0**	**2,000**	**55,726**
04120	Mbikëqyrja e tregut & Garantimi i konkurrencës	53,726	2,000	0	0	2,000	55,726
78	**Ministria e Integrimit**	**117,346**	**16,000**	**0**	**37,000**	**53,000**	**170,346**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	43,779	1,000	0	0	1,000	44,779
01140	Drejtësia dhe Tregu i Brendshëm	24,476	1,300	0	0	1,300	25,776
01150	Mbështetja Institucionale për Procesin e Integrimit	49,091	13,700	0	37,000	50,700	99,791
82	**Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit**	**11,843**	**1,300**	**0**	**0**	**1,300**	**13,143**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	11,843	1,300	0	0	1,300	13,143
86	**Avokati i Prokurimeve**	**21,600**	**2,000**	**0**	**0**	**2,000**	**23,600**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	21,600	2,000	0	0	2,000	23,600
87	**Institucione te tjera Qeveritare**	**742,274**	**506,700**	**0**	**20,000**	**526,700**	**1,268,974**
01320	Shërbime Qeveritare	100,000	27,605	0	0	27,605	127,605
01130	Shërbimi i Prokurimit Publik	54,178	9,700	0	0	9,700	63,878
01140	Shërbime për Shoqërinë e Informacionit	487,296	305,395	0	20,000	325,395	812,691
01150	Shërbime të tjera	79,103	106,000	0	0	106,000	185,103
01510	Shërbime për Teknologjinë dhe Inovacionin	21,697	58,000	0	0	58,000	79,697
88	**Mbështetje për Shoqërinë Civile**	**92,792**	**2,000**	**0**	**0**	**2,000**	**94,792**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	92,792	2,000	0	0	2,000	94,792
89	**Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale**	**40,387**	**3,000**	**0**	**0**	**3,000**	**43,387**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	40,387	3,000	0	0	3,000	43,387
91	**Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi**	**27,106**	**11,500**	**0**	**0**	**11,500**	**38,606**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	27,106	11,500	0	0	11,500	38,606
92	**Instituti i Studimeve te Krimeve të Komunizmit**	**26,508**	**3,000**	**0**	**0**	**3,000**	**29,508**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	26,508	3,000	0	0	3,000	29,508
TOTALI		**178,044,706**	**26,318,454**	**23,000**	**37,547,891**	**63,889,345**	**241,934,051**

ne 000/leke

Të tjera shpenzime të papërfshira në buxhetet e ministrive dhe institucioneve	Totali
Fondi rezerve dhe kontigjencë i Këshillit të Ministrave	**7,800,000**
Fondi rezervë i Këshillit të Ministrave	1,800,200
Fondi rezerve për Politikë Pagash (e pakushtëzuar)	754,800
Fondi i kontigjencës për politika pensionesh	1,500,000
Fondi kontigjence për ruajtjen e deficitit	2,600,000
Fondi i veçantë për pagat	1,145,000
Interesat	**42,200,000**
Për borxhin e brendshëm	34,200,000
Për borxhin e huaj	8,000,000
Shpenzimet e pushtetit vendor	**27,048,500**
Nga te ardhurat e veta	11,072,500
Granti për pushtetin vendor	13,876,000
Shpenzime nga të ardhurat e arsimit të lartë	**2,400,000**
Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit	**1,600,000**
Investime nga të ardhurat jashtë limitit të arsimit të lartë	**800,000**
Të ardhurat e fondeve speciale	**58,513,000**
Totali	**140,361,500**

TREGUESIT FISKALË TË AKTIT NORMATIV 2012

në milion lekë (in millon of leks)

Nr.	E M E R T I M I	Buxheti 2012	Akti Normativ 2012	Diferenca	I T E M S
	TOTALI TE ARDHURAVE	**355,759**	**332,758**	**-23,002**	**TOTAL REVENUE**
I.	**Te ardhura nga ndihmat**	**9,843**	**4,020**	**-5,823**	**Grants**
	Nga kjo:mbështetje buxhetore				From which: Budget Support
II.	**Te ardhura tatimore**	**325,306**	**305,508**	**-19,798**	**Tax Revenue**
II.1	**Nga tatimet dhe doganat**	**251,168**	**235,922**	**-15,246**	**From tax offices and customs**
1	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	127,299	119,040	-8,259	V.A.T
2	Tatimi mbi Fitimin	21,980	16,552	-5,428	Profit Tax
3	Akcizat	42,759	36,492	-6,267	Excise Tax
4	Tatimi mbi te Ardhurat Personale	29,754	28,128	-1,626	Personal Income Tax
5	Taksa Nacionale dhe te tjera	22,598	29,657	7,059	National Taxes and others
6	Taksa Doganore	6,778	6,053	-725	Customs Duties
II.2	**Të ardhura nga Pushteti Lokal**	**14,624**	**11,073**	**-3,552**	**Local Taxes**
1	Taksa Lokale	9,409	6,580	-2,829	Local Taxes
2	Tatimi mbi Pasurinë (ndërtesat)	2,132	2,690	558	Property Tax
3	Tatimi mbi Biznesin e vogel	3,083	1,803	-1,280	Small Business Tax
II.3	**Të ardhura nga Fondet Speciale**	**59,513**	**58,513**	**-1,000**	**Revenues from Special Funds**
1	Sigurimi Shoqëror	51,577	50,577	-1,000	Social Insurance
2	Sigurimi Shëndetësor	6,436	6,436	0	Health insurance
3	Te ardhura për Kompensimin ne Vlere te Pronareve	1,500	1,500	0	Revenues for owners' in value-compensation
III.	**Te ardhura jotatimore**	**20,611**	**23,230**	**2,619**	**Nontax Revenue**
1	Tran.Fitimi nga Banka e Shqipërisë	4,500	4,500	0	Profit transfer from BOA
2	Te ardhura nga Inst.Buxhetore	12,411	9,150	-3,261	Income of budgetary institutions
3	Dividenti	700	430	-270	Divident
4	Tarifat e shërbimeve	2,500	3,850	1,350	Services Fees
5	Te tjera	500	5,300	4,800	Others
	TOTALI I SHPENZIMEVE	**396,922**	**382,296**	**-14,626**	**TOTAL EXPENDITURE**
I.	**Shpenzime korrente**	**322,389**	**313,206**	**-9,183**	**Current Expenditures**
1	**Personeli**	**70,866**	**69,236**	**-1,630**	**Personnel expenditures**
	Paga	58,535	58,025	-510	Wages
	Kontributi për Sigurime Shoqërore	9,400	9,311	-89	Social insurance contributions
	Fondi i veçantë i pagave	1,931	1,145	-786	Bonus fund
	Politikat e reja pagash	1,000	755	-245	Contingency for new policies
2	**Interesat**	**49,600**	**42,200**	**-7,400**	**Interest**
	Te Brendshme	40,000	34,200	-5,800	Domestic
	Te Huaja	9,600	8,000	-1,600	Foreign
3	**Shpenzime operative mirëmbajtje***	**29,062**	**31,168**	**2,106**	**Operational & Maintenance**
4	**Subvencionet**	**1,600**	**1,625**	**25**	**Subsidies**
6	**Shpenzime për Fondet Speciale**	**121,999**	**120,999**	**-1,000**	**Social insurance outlays**
	Sigurime Shoqërore	89,765	88,765	-1,000	Social insurance
	Sigurime Shëndetësore	28,934	28,934	0	Health insurance
	Politika te reja pensionesh	1,500	1,500	0	Contingency for new policies
	Shpenzime për Kompensimin ne Vlere te Pronareve	1,800	1,800	0	Expenditure for owners' in value-compensation
7	**Shpenzime per Buxhetin Lokal**	**29,503**	**27,049**	**-2,455**	**Local Budget expenditure**
	Buxheti lokal (Granti)	13,876	13,876	0	Local Budget (Grant)
	Buxheti lokal (Te ardhurat e veta)	14,624	11,073	*-3,552*	Local Budget (Own revenues)
	Buxheti Lokal (Te ardhurat nga transferimi i rentës)	*1,003*	*100*	*-903*	*Local Budget (Revenues from rent transfer)*
	Buxheti Lokal (Te ardhurat e veta jo-tatimore)		*2,000*	2,000	Local Budget (Non tax revenues)
8	**Shpenzime te tjera**	**19,759**	**20,929**	**1,170**	**Other expenditures**
	Pagesa e Papunësisë	1,000	1,000	0	Unemployment insurance benefits
	Ndihma Ekonomike	17,059	18,229	1,170	Social assistance
	Nga e cila: Shpërblim per pensionistet	0	1,170	1,170	*from which: Pensioner bonus*
	Kompensim për te përndjekurit politike	1,700	1,700	0	Compensation for ex political prisoners
II.	**Fondi Rezerve, Kontigjenca**	**4,661**	**4,400**	**-261**	**Reserve fund, Contingency**
	Fondi Rezerve i Këshillit te Ministrave	2,000	1,800	-200	CoM Reserve Fund
	Fondi Kontigjence për Ruajtjen e Deficitit	2,661	2,600	-61	Contingency for deficit financing
III.	**Shpenzime Kapitale**	**69,872**	**64,689**	-5,183	**Capital expenditures**
	Financimi Brendshëm	27,501	26,341	-1,160	Domestic financing
	nga i cili: Arsimi i Larte		800	800	*from which: Higher education*
	Financimi Huaj	42,371	37,548	-4,823	Foreign financing
	DEFIÇITI	**-41,163**	**-49,538**	**-8,375**	**Cash Balance**
	FINANCIMI DEFIÇITIT	**41,163**	**49,538**	**8,376**	**Financing (Cash)**
	Brendshëm	**18,815**	**27,190**	**8,376**	**Domestic**
	Te ardhura nga privatizimi	300	900	601	Privatization receipts
	Hua-marrje e brendshme	18,515	26,290	7,775	Domestic borrowing
	I Huaj	**22,348**	**22,348**	**0**	**Foreign**
	Hua afatgjate(e marre)	32,528	33,528	1,000	Long-term Loan(Drawings)
	Ripagesat	-10,180	-11,180	-1,000	Repayments
	Produkti i Brendshem Bruto (PBB)	***1,389,791***	***1,360,914***	***-28,877***	

UDHËZIM
Nr. 370, datë 7.12.2012

PËR PROCEDURAT E PASTRIMIT TË DUBLIMEVE TË SHTETASVE SHQIPTARË NGA REGJISTRAT THEMELTARË DHE REGJISTRI KOMBËTAR I GJENDJES CIVILE

Në zbatim të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 14,15, të pikës 3 të nenit 30, të nenit 36, të germave "a", "c" dhe "d" të nenit 65 të ligjit nr. 10129, datë 11.5.2009 "Për gjendjen civile", si dhe në mbështetje të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1243, datë 11.12.2009 "Për përcaktimin e dokumenteve që duhet të paraqesin shtetasit, e të procedurave, që duhet të kryejnë zyrat e gjendjes civile, në bashki/njësi bashkiake/komuna dhe institucionet shtetërore të posaçme, për ndryshimin e vendbanimit/adresës së shtetasve", me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile,

UDHËZOJ:

I. VEPRIMTARITË PARAPRAKE

1. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, mbështetur në bazën e të dhënave të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile, të identifikojë dhe të hartojë listën e shtetasve të dyshuar si të dubluar, sipas procedurës në aneksin nr. 1.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile verifikon edhe listat me emra të personave të dyshuar si të dubluar që mund të dërgojnë institucionet shtetërore të përfshira në procesin zgjedhor, si: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve; bashki/njësi bashkiake dhe komuna në formatin elektronik excel me rubrikat: emri, mbiemri, emri i babait, emri i nënës, datëlindja, vendlindja, gjinia, numri personal (në pamundësi të numrit personal, numri rendor sipas ekstraktit të përbërësve zgjedhorë) dhe vendbanimi (njësia vendore). Këto lista dorëzohen në DPGJC brenda 20 (njëzet) ditëve nga publikimi i ekstraktit të parë të përbërësve zgjedhorë sipas Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë. DPGJC-ja i grupon këto lista në një listë sipas formatit të aneksit nr. 2.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, listën sipas aneksit nr. 1 do ta ballafaqojë me listën emërore, sipas aneksit nr. 3, në të cilën përfshihen binjakët dhe personat e ndryshëm të identifikuar nga zyrat e gjendjes civile nga zbatimi i udhëzimit nr. 359, datë 11.10.2010 të Ministrit të Brendshëm.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, listën e përftuar nga procedura sipas pikës 2, do ta ballafaqojë me bazën e të dhënave të shtetasve që janë pajisur me letërnjoftim elektronik.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, listën e ardhur nga institucionet shtetërore të përfshira në proces, të hartuar sipas aneksit nr. 2, do ta ballafaqojë me RKGJC. Listën që përftohet nga ky proces, do ta ballafaqojë me listën sipas aneksit nr. 3.

5. Listën e përftuar sipas pikës 4 të këtij udhëzimi, do ta ballafaqojë me bazën e të dhënave të shtetasve që janë pajisur me letërnjoftim.

6. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, listën e përftuar sipas procedurës së pikës 3 e dërgon në çdo zyrë të gjendjes civile në bashki/njësi bashkiake/komunë, brenda 15 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi.

Listën e përftuar sipas pikës 5, DPGJC e dërgon në çdo zyrë të gjendjes civile në bashki/njësi bashkiake/komunë brenda 5 ditëve nga marrja e listës nga institucionet e përfshira në proces. Listat emërore të shtetasve të dyshuar si të dubluar, grupohen si më poshtë:

a) Dublime të dyshuara brenda së njëjtës zyrë të gjendjes civile.

b) Dublime të dyshuara midis zyrave të gjendjes civile.

7. Zyra e gjendjes civile, pasi të marrë listën emërore, mbledh gjithë informacionin e nevojshëm për këta shtetas, si:

- datën e regjistrimit në regjistrin themeltar;
- arsyen e regjistrimit;
- zyrën e gjendjes civile nga ka ardhur;
- si dhe çdo informacion tjetër që ndihmon në saktësinë e procedurës së pastrimit të dublimit për individin/familjen.

II. VEPRIMET ME DUBLIMET BRENDA SË NJËJTËS ZYRË TË GJENDJES CIVILE

8. Përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile, pasi ka mbledhur informacionin sipas pikës 7, fillon së pari me grupin e shtetasve të dyshuar si të dubluar brenda zyrës.

9. Për këtë përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile duhet të gjejë, të kontrollojë dhe të krahasojë përbërësit e gjendjes civile të këtyre shtetasve në regjistrin themeltar. Në rast se këto të dhëna përputhen dhe krijon bindjen se është i njëjti individ/familje, atëherë duhet të çregjistrojë individin/familjen në fletën ku arsyeton se duhet të kryhet. Për këtë duhet të shfrytëzojë të gjitha të dhënat e tjera shtesë që ka regjistri për individin/familjen.

10. Pasi ka mbaruar me veprimet në regjistrin themeltar, duhet të fillojë procedurën me veprimet në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.

Për të gjitha rastet e konstatuara si të dubluara apo fiktive, për individin/familjen, do të kryejë veprimet në RKGJC, sipas manualit bashkëlidhur.

III. VEPRIMET ME DUBLIMET MIDIS ZYRAVE TE GJENDJES CIVILE

Grupi parë (në regjistrin themeltar kemi shënime në rubrikën “burimi i informacionit”)

11. Secila zyrë e gjendjes civile do të ballafaqojë nëse të dhënat e individit/familjes, që gjendet në listën e sjellë nga DPGJC, janë në përputhje me të dhënat e individit/familjes që ka të regjistruar në regjistrat themeltarë.

12. Kur binden se të dhënat i përkasin këtij individi/familje, atëherë i krahasojnë me të dhënat që kanë në RKGJC.

13. Zyra e gjendjes civile, që verifikon se:

a) shënimet në rubrikën “Burimi i informacionit”, si numri i librit dhe i fletës, emri i regjistrit dhe emri i zyrës së gjendjes civile, përputhen me të dhënat e zyrës, ku ky shtetas figuron i dubluar; dhe

b) dinamika e të dhënave të individit/familjes provon se ku ky individ/familje është aktiv/e, atëherë punonjësi i zyrës së gjendjes civile plotëson dhe printon menjëherë nga sistemi në letër A4 (jo certifikatë) të dhënat në formën e certifikatës familjare dhe ia dërgon zyrës së gjendjes civile nga e cila rezulton se ka ardhur.

14. Zyra e gjendjes civile, që merr njoftim sipas pikës 13, kryen çregjistrimin e individit/familjes, fillimisht në regjistrin themeltar dhe më pas në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.

15. Pasi kryen çregjistrimin nga të dy regjistrat, i dërgon konfirmimin zyrës nga e cila i erdhi formulari, duke e informuar se çregjistrimi u krye.

Grupi dytë (në regjistrin themeltar nuk kemi shënime në rubrikën “Burimi i informacionit”)

16. Për rastet kur në regjistrin themeltar nuk kemi shënime në rubrikën “Burimi i informacionit”, atëherë kjo zyrë duhet t’i kërkojë informacion zyrës ku kjo familje figuron e dubluar sipas listës bashkëlidhur.

17. Zyra që merr kërkesën për informacion, brenda 5 ditëve, plotëson të dhënat që rezultojnë në të gjitha rubrikat e regjistrit (nga rubrika 1-32, ose fotokopje të fletës së familjes) dhe ia dërgon këto zyrës që ka kërkuar informacion.

18. Zyra që kërkoi informacion sipas pikës 16 dhe mori përgjigje sipas pikës 17, e ballafaqon informacionin e marrë me të dhënat e fletëfamiljes së saj. Në këtë rast, ka dy mundësi:

a) Kur fletëfamilja përmban të gjitha të dhënat, që përcaktojnë se familja është regjistruar në këtë fletë familje si pasojë e një transkriptimi, do të ketë prioritet për të qëndruar në këtë regjistër, në krahasim me familjen, e cila gjendet e regjistruar në zyrën tjetër dhe nuk ka shënim në rubrikën

"Burimi i informacionit", si dhe nuk ka kryer asnjë veprim në këtë fletëfamilje. Pasi krahason të dy fletëfamiljet, zyra e gjendjes civile, ku individi/familja është regjistruar pa burim informacioni dhe nuk ka kryer veprime, duhet ta çregjistrojë atë nga regjistri themeltar dhe nga RKGJC. Pasi kryen këto veprime, informon zyrën e gjendjes civile nga e cila mori të dhënat se çregjistrimi u krye.

b) Kur individi/familja, edhe pse në fletë familjen e tij/saj, nuk ka shënim në rubrikën "Burimi i informacionit ", por ka kryer veprime në këtë zyrë si regjistrime lindje, martese, vdekje etj, ky/kjo individ/familje do të qëndrojë në këtë regjistër dhe nëpunësi i zyrës së gjendjes civile do t'i kërkojë zyrës së gjendjes civile nga e cila mori informacionin që të çregjistrojë individin/familjen. Zyra e gjendjes civile që merr këtë kërkesë, bën çregjistrimin e individit/familjes në regjistrin themeltar dhe në RKGJC dhe njofton zyrën tjetër që çregjistrimi u krye.

c) Në rast se pas verifikimit të të dhënave të individit/familjes me të dhënat në regjistrin themeltar rezulton se referencat janë po ato, por jo të gjitha rubrikat e të dhënave përputhen, atëherë kemi rastin e një fletëfamiljeje fiktive.

Kur bindet se ka të bëjë me një fletë familje fiktive, do të çregjistrojë individin/familjen nga regjistri themeltar, duke mbajtur procesverbalin e posaçëm dhe më pas do të bllokojë këtë individ/familje në RKGJC me anë të procedurës "Blloko person", siç shpjegohet në manualin bashkëlidhur.

Nëse më pas provohet se kjo familje nuk është fiktive, atëherë do të rikthehet në gjendjen e mëparshme, duke marrë miratimin në DPGJC.

ç) Për të gjitha praktikat e dublimeve të mbetura pezull, bëhet verifikimi dhe printimi nga regjistri kombëtar i përbërjes familjare në të dyja a më shumë zyra, sipas rastit, ku ato figurojnë si individ/familje të dubluar. Më pas plotësohet dosja përkatëse për secilin rast, duke kërkuar fotokopje dhe të fletëve të regjistrit nga kanë ardhur, dhe/ose nga zyrat ku ato figurojnë ende të dubluar. Pas verifikimit, kryhen veprimet për çregjistrimin e tyre sipas rastit si familje, kur ato figurojnë si familje dhe kur informacioni është i saktë e përputhet. Për rastet kur përmbajtja e fletës familjare ka mospërputhje dhe ndryshime në datëlindje dhe këto ndryshime nuk mbështeten në një libër aktesh apo dokument bazë, të pasqyruar si burim informacioni (zyra e gjendjes civile vërteton se kjo familje nuk ka qenë asnjëherë e regjistruar në atë zyrë nga ka ardhur fletëfamilja dhe nga ajo zyrë nuk është dërguar një fletë familje e tillë, d.m.th. nuk përputhet shënimi në regjistër i rubrikës se nga ka ardhur me zyrën përkatëse), atëherë në mbështetje të pikës 3 të nenit 30 të ligjit nr. 10129, datë 11.05.2009, përmbajtja e fletës familjare të regjistrit është e pavlefshme dhe për pasojë këta shtetas duhet të çregjistrohen nga regjistri themeltar dhe Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile, pasi janë shtetas të regjistruar fiktivë.

Grupi tretë (dublime të krijuara si pasojë e mosdërgimit të njoftimit të martesës)

19.a) Zyra që verifikon se individi që ballafaqoi në regjistrin e saj është i martuar dhe dublimi është krijuar si pasojë e mosdërgimit të njoftimit të martesës në zyrën e gjendjes civile, ku individi figuron beqar, nëpunësi i gjendjes civile vepron në këtë mënyrë: Zyra e gjendjes civile ku individi figuron i martuar, pasi bën verifikimin që vërteton se ka të bëjë me të njëjtin individ (në rubrikën burimi i informacionit përputhen të dhënat që ky individ ka ardhur me martesë nga zyra ku figuron i dubluar), nëpunësi i zyrës së gjendjes civile plotëson njoftimin e martesës, duke cilësuar dhe vendin ku është lidhur martesa dhe ia dërgon zyrës ku ky i fundit figuron beqar.

b) Në të njëjtën mënyrë do të veprohet dhe për rastet kur martesat janë bërë në përfaqësitë tona diplomatike dhe njoftimi i martesës nuk i ka vajtur zyrës së gjendjes civile ku individi figuron beqar. Zyra e gjendjes civile ku individi figuron i martuar, plotëson certifikatën e martesës me shënimin se ku është e lidhur kjo martesë dhe ia dërgon zyrës së gjendjes civile ku individi figuron beqar.

c) Në të dyja rastet, sipas e germave "a" dhe "b" të pikës 19, zyra e gjendjes civile ku individi figuron beqar, pasi merr njoftimin apo certifikatën e martesës, bën ballafaqimin e të dhënave dhe më pas bën çregjistrimin sipas njoftimit të ardhur në regjistrin themeltar dhe në RKGJC.

Grupi i katërt (dublim i krijuar në sistemin *online*)

20. Në rast se dublimi ka ardhur si pasojë e mbajtjes së dy akteve lindjeje në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile për të njëjtin person, atëherë do të verifikohen të dyja aktet:

a) Nëse janë të njëjtë në përmbajtje, do të fshihet akti i cili është mbajtur më vonë.

b) Nëse janë të ndryshëm, do të gjykohet rast pas rasti dhe do të vendoset nga nëpunësi i gjendjes civile, se cili nga aktet është i vlefshëm dhe cili rekord i krijuar prej tij do të mbahet.

21. Në rast se dublimi ka ardhur si pasojë e shtimit të shtetasit në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, me procedurën "Shto person" kryhet verifikimi se kur është kryer veprimi dhe për çfarë arsye është krijuar personi. Sipas informacionit, nëpunësi i gjendjes civile gjykon dhe vendos se cilin prej rekordeve do të çregjistrojë dhe më pas kryen procedurën e pastrimit të dublimit në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.

22. Në çdo rast pastrim dublimi, nëpunësi i gjendjes civile për çdo shtetas të listës së ardhur nga DPGJC, verifikon edhe të dhënat për çdo pjesëtar të familjes së tij në regjistrin themeltar dhe në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.

23. Zyra e gjendjes civile, e cila ka marrë listë për dublime të dyshuara nga DPGJC, brenda 60 ditëve nga data e marrjes së listës paraqet në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile listën e individëve/familjeve që ka çregjistruar sipas procedurës së mësipërme, si dhe listën e atyre që nuk ka çregjistruar me arsyen përkatëse.

24. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, si dhe të gjitha zyrat e gjendjes civile në bashki/njësi bashkiake/komuna.

25. Udhëzimi nr. 359, datë 11.10.2010 i Ministrit të Brendshëm, shfuqizohet.

26. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletore Zyrtare.

MINISTRI I BRENDSHËM
Flamur Noka

ANEKSI NR.1
PROCEDURA E KONTROLLIT TË DUBLIMEVE

Shënim. Procedurat nuk marrin parasysh ndryshimet e germave "C" me "Ç" dhe "E" me "Ë" pra "Clirim" dhe "Çlirim" quhet i njëjti emër dhe kapet si dublim (emrat Engjellushe e Engjëllushe).

1. **Procedura A:** Kap personat me **emër, mbiemër, emri i nënës, emri i babait**, dhe **datëlindje** të njëjtë.

2. **Procedura B1**: Kap personat me **emër, mbiemër, emri i babait, emri i nënës, vendlindje** dhe **vitlindje** të njëjtë.

3. **Procedura B2:** Kap personat **me emër, mbiemër, emri i babait, emri i nënës, vendlindje** dhe **ditë** të njëjtë.

4. **Procedura B3:** Kap personat me **emër, mbiemër, emri i babait, emri i nënës, vendlindje** dhe **muaj** të njëjtë.

5. **Procedura B4:** Kap personat me **emër, mbiemër, emri i babait, emri i nënës, vendlindje** të njëjtë dhe ndryshon **datëlindja** në 1 shifër.

6. **Procedura Ç:** Kap personat me **emër, emri i babait, emri i nënës, datëlindje** të njëjtë dhe **mbiemri** ndryshon me një germë, por numri i karaktereve është i njëjtë (deri në 16 karaktere).

7. **Procedura D:** Kap personat me **mbiemër, emri i babait, datëlindje** të njëjtë dhe **emri** ndryshon me një germë, por numri i karaktereve është i njëjtë (deri në 16 karaktere).

8. **Procedura E:** Kap personat me **emër, mbiemër, emri i nënës, datëlindje** të njëjtë dhe **emri i babait** ndryshon me një germë, por numri i karaktereve është i njëjtë (deri në 16 karaktere).

9. **Procedura F:** Kap personat me **mbiemër, emri i babait, emri i nënës, datëlindje, kod zgjc, të dhënat e regjistrit (emër, faqe, rendor)** të njëjtë ndryshon **emri**.

10. **Procedura G:** Kap personat me **emri i babait, mbiemër, emri i nënës, datëlindje** të njëjtë dhe **emri** ndryshon me një germë ose dy, dhe numri i karaktereve të **emrit** ndryshon me një ose dy.

11. **Procedura H:** Kap personat me **emër, emri i babait, emri i nënës, datëlindje** të njëjtë dhe **mbiemri** ndryshon me një germë ose dy, dhe numri i karaktereve të **mbiemrit** ndryshon me një ose dy.

12. **Procedura J:** Kap personat me **emër, mbiemër, emri i nënës, datëlindje** të njëjtë dhe **emri i babait** ndryshon me një germë ose dy dhe numri i karaktereve të **emri i babait** se ndryshon me një ose dy.

13. **Procedura K:** Kap personat me **emër, emri i babait, emri i nënës, datëlindje** të njëjtë, Seksi=Femër dhe **mbiemri** ndryshon (Për të kapur gratë e martuara që kanë mbetur pa u çregjistruar).

14. **Procedura L:** Kap personat me **emër, mbiemër, emri i babait, datëlindje** të njëjtë dhe **emri i nënës** ndryshon me një germë, por numri i karaktereve është i njëjtë (deri në 16 karaktere).

15. **Procedura M:** Kap personat me **emri, mbiemri, emri i babait, datëlindje** të njëjtë dhe **emri i nënës** ndryshon me një germë ose dy dhe numri i karaktereve.

16. **Procedura N1:** Kap personat me **emër, mbiemër, emri i babait, emri i nënës, datëlindje** të njëjtë dhe **vendlindja** ndryshon me një germë, por numri i karaktereve është i njëjtë (deri në 16 karaktere).

17. **Procedura N2:** Kap personat me **emër, mbiemër, emri i babait, emri i nënës, datëlindje** të njëjtë dhe ndryshon me një germë deri në katër dhe numri i karaktereve te **vendlindja** ndryshon me një deri në katër.

18. **Procedura O:** Kap personat me **mbiemër, emri i babait, emri i nënës, datëlindje**, **vendlindja** të njëjtë dhe **emri** i ndryshëm.

19. **Procedura P:** Kap personat me **mbiemër, emri i babait, emri i nënës, datëlindje**, **vendlindja, kodi i zyrës** të njëjtë dhe **emri** i ndryshëm.

ANEKSI NR.2

Nr.	Emri	Mbiemri	Emri i babait	Emri i nënës	Datëlindja	Vendlindja	Gjinia	Numri personal	Numri zgjedhor	Numri rendor

MINISTRIA E BRENDSHME
Drejtoria e pergjithshme e Gjendjes Givile

Manuali:

- Pastrimi i Dublimeve

Në këtë manual merren parasysh rasti Brenda zyres dhe jashte zyres:

1. **Te dy rekordet aktive:** Te dy rekordet jane aktive në regjistër.

Pas verifikimeve do te mbetet aktiv rekordi qe ka të dhënat e duhura.

a. Dublim Brenda zyrës

Hapat:

1. Personit që do të mbetet në historik fillimisht i cregjistrohet vendbanimi.
   Fig. 1



2. Te pastrimi i të dhenave pastrohet dublimi, duke plotësuar numrat personal përkates:
   Fig.2



MINISTRIA E BRENDSHME
Drejtoria e pergjithshme e Gjendjes Givile

Fig.3

3. Kryhet bashkimi familjar

Fig. 4



4. Ndryshohet marredhenia me kryefamiljarin dhe renditja ne familje.

Fig. 5



b. dublim ZGJC te ndryshme
hapat:

1. Personit që do te mbete ne historik fillimisht I cregjistrohet vendbanimi. (Fig.1)
2. Te pastrimi i te dhenave pastrohet dublimi.(Fig.2)
3. Korigjohet vendbanimi:
   (Fig.6)



4. Ndryshohet zgjc dhe kodi i votimit
5. Kryhet bashkimi familjar.**Fig.4**
6. Ndryshohet marredhenia me kryefamiljarin dhe renditja ne familje.**(Fig.5)**
7. Ne disa raste mund te jete e nevojshme te ndryshohen edhe perberesit e gjendjes civile, psh. emri, mbiemri, datelindja, vendlindja etj.

MINISTRIA E BRENDSHME
Drejtoria e pergjithshme e Gjendjes Givile

- # Bllokimi I Shtetasit

1. Kerkojme personin qe do te bllokohet:



2. Pasi jemi siguruar qe te dhenat e gjetura perputhen me ato te personit qe duam te bllokojme klikojme ne te majte te : **(jo)bllokim personi**

MINISTRIA E BRENDSHME
Drejtoria e pergjithshme e Gjendjes Givile

3. Pasi kemi dhene arsyen e bllokimit te ketij personi klikojme **Ruaj** dhe do t'iu shfaqet mesazhi: **Personi u bllokua me sukses.**



VENDIM
Nr. 52, datë 5.12.2012

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar	i Gjykatës	Kushtetuese
Vladimir Kristo	Anëtar	i "	"
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i "	"
Vitore Tusha	Anëtare	e "	"
Sokol Berberi	Anëtar	i "	"
Altina Xhoxhaj	Anëtare	e "	"
Admir Thanza	Anëtar	i "	"
Fatmir Hoxha	Anëtar	i "	"

me sekretare Edmira Babaj, në datën 28.06.2012 mori në shqyrtim, në seancë gjyqësore, çështjen nr. 20 Akti, që i përket:

KËRKUES: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier; Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar me autorizim nga Arjeta Cefa;

Këshilli i Ministrave, përfaqësuar me autorizim nga Marsida Xhaferllari;

Avokatura e Shtetit, përfaqësuar me autorizim nga Manjola Trungaj;

"CEZ Shpërndarje" sh.a. Tiranë, përfaqësuar me prokurë nga av.Sokol Nako dhe juristja Aurora Limadhi.

OBJEKTI: Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën, i ligjit nr.8662, datë 18.09.2000 "Për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës së konsumit të energjisë elektrike", ndryshuar me ligjin nr.8735, datë 01.02.2001 "Për një shtesë në ligjin nr.8662, datë 18.09.2000 'Për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës së konsumit të energjisë elektrike'", i shtuar me ligjin nr.10486, datë 26.11.2011 "Për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës së konsumit të energjisë elektrike".

BAZA LIGJORE: Nenet 134/1, shkronja "d" dhe 145/2 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Bashkim Dedja, shqyrtoi pretendimet e gjykatave referuese, të cilat kërkuan shfuqizimin e ligjit; prapësimet e subjekteve të interesuara, të cilat kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës dhe pasi e diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr.4, datë 26.03.2012, ka vendosur pezullimin e gjykimit të çështjes me paditës: Pompë Uji Selishtë, komuna Cakran; të paditur: "CEZ Shpërndarje" sh.a., përmbaruesi gjyqësor privat VSH; me objekt: deklarimin e pavlefshmërisë së titujve ekzekutivë, faturat e shitjes së energjisë elektrike (...) dhe dërgimin e çështjes Gjykatës Kushtetuese, për t'u shprehur në lidhje me kushtetutshmërinë e ligjit nr.8662, datë 18.09.2000 "Për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës së konsumit të energjisë elektrike", me ndryshimet përkatëse.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin e datës 10.04.2012, ka vendosur pezullimin e gjykimit të çështjes, me kërkues: "CEZ Shpërndarje" sh.a., me objekt: lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për faturat e energjisë elektrike për abonentin K.S. dhe dërgimin e çështjes Gjykatës Kushtetuese, për t'u shprehur në lidhje me kushtetutshmërinë e ligjit nr.8662, datë 18.09.2000 "Për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës së konsumit të energjisë elektrike", me ndryshimet përkatëse.

3. Ligji nr.8662, datë 18.09.2000 "Për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës së konsumit të energjisë elektrike", i ndryshuar me ligjin nr.8735, datë 01.02.2001 "Për një shtesë në ligjin nr.8662, datë 18.09.2000 "Për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës së konsumit të energjisë elektrike'", i shtuar me ligjin nr.10486, datë 26.11.2011 "Për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës së konsumit të energjisë elektrike" (në vazhdim ligji për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës së konsumit të energjisë elektrike), i cili përbëhet vetëm nga 3 nene, në nenin 1 ka këtë përmbajtje: "*Fatura tatimore e konsumit, të shitjes, të blerjes dhe faturat e shërbimit të transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, sipas modelit të caktuar nga Ministria e Financave, në zbatim të nenit 36 të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", është titull ekzekutiv dhe ngarkohen zyrat e përmbarimit me ekzekutimin e tyre*".

4. Gjatë shqyrtimit paraprak, Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, më datë 14.05.2012, vendosi kalimin në seancë plenare të çështjeve me kërkues: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë (gjykatat referuese), duke i bashkuar në një të vetme.

II

5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ka vënë në dyshim kushtetutshmërinë e ligjit për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës së konsumit të energjisë elektrike, duke parashtruar këto argumente:

5.1 Përcaktimi i një akti si titull ekzekutiv do të thotë që ky i fundit t'i nënshtrohet procedurës së ekzekutimit, pa e marrë konfirmimin e ekzistencës së tij përmes një procesi të rregullt ligjor. Në këtë kuptim cenohet e drejta e pronësisë e debitorit, nëpërmjet një procesi jo të rregullt ligjor, sepse procedura e lëshimit të urdhrit të ekzekutimit nuk përmbush standardet e këtij procesi. Edhe sikur kufizimi i së drejtës për një proces të rregullt ligjor të jetë bërë për mbrojtjen e interesave publikë, sipas kritereve të nenit 17 të Kushtetutës, ai nuk është proporcional me gjendjen që e ka diktuar atë.

5.2 Në nenin 510/e të Kodit të Procedurës Civile (KPC), është parashikuar se edhe akte të tjera sipas ligjeve të veçanta quhen tituj ekzekutivë dhe ngarkohet zyra e përmbarimit për ekzekutimin e tyre. Me "*ligje të veçanta*" duhet të kuptohen ligje të barasvlefshme me KPC-në, pra ligje që miratohen me shumicë të cilësuar, ndërsa ligji për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës së konsumit të energjisë elektrike është bazuar në nenin 78 dhe 83/1 të Kushtetutës, duke u miratuar me shumicë të thjeshtë.

5.3 Ligji për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës së konsumit të energjisë elektrike ka përmbajtje evazive, duke i lënë hapësirë interpretimi gjyqtarit të zakonshëm. Ligji nuk ka të qartë objektin, qëllimin e ligjvënësit dhe përkufizimet. Duke mos i pasur të qarta këto elemente, kuptimi i termit "faturë e konsumit të energjisë elektrike" nga pikëpamja e përmbajtjes së detyrimit që duhet të ketë një faturë konsumi e energjisë elektrike, është i vështirë të gjendet, prandaj dhe ky ligj cenon hapur parimin e sigurisë juridike.

6. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vënë në dyshim kushtetutshmërinë e ligjit për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës së konsumit të energjisë elektrike, duke parashtruar këto argumente:

6.1 Procesi gjyqësor i lëshimit të urdhërimit të ekzekutimit është një proces pa palë kundërshtare. Subjekti ndaj të cilit kërkohet lëshimi i urdhrit të ekzekutimit nuk thirret në gjykim, nuk dëgjohet, nuk mund të njihet me argumentet dhe provat e palës kërkuese, të debatojë në lidhje me to dhe të mbrohet. Për rrjedhojë, debitori/individi nuk gëzon të drejtën për një proces të rregullt ligjor të parashikuar nga neni 42/1 i Kushtetutës. Për më tepër, ky ligj nuk përmbush kriteret e kërkuara nga neni 17 i Kushtetutës në rastin e kufizimeve të të drejtave të njeriut.

6.2 "CEZ Shpërndarje" sh.a. është regjistruar si shoqëri tregtare dhe vepron në treg si furnizuese e energjisë elektrike me kontratë. Kontrata mes CEZ sh.a. dhe abonentit është kontratë individuale mes dy subjekteve të barabarta, të cilat çdo konflikt që buron prej saj duhet ta zgjidhin me padi themeli në gjykatë.

6.3 Ligji vjen në kundërshtim me parimin e shtetit të së drejtës dhe me parimin e sigurisë juridike. Si pasojë e paqartësisë dhe mungesës së parashikimeve tekstuale ligjore, në çështjet civile, me objekt lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për faturat e energjisë elektrike janë konstatuar praktika të ndryshme të gjykatave lidhur me faktin nëse kamatëvonesat janë tituj ekzekutivë, si pjesë përbërëse e faturës së energjisë elektrike.

7. ***Kuvendi***, si palë e interesuar, ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, duke parashtruar këto argumente:

7.1 Gjykatat referuese nuk duhet të legjitimohen, sepse nuk ekziston lidhje e drejtpërdrejtë mes ligjit të kundërshtuar dhe zgjidhjes së çështjes konkrete. Gjatë parashtrimeve, edhe pse kanë kërkuar në objekt vlerësimin e papajtueshmërisë së ligjit për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës së konsumit të energjisë elektrike me Kushtetutën, gjykatat referuese në fakt kanë kundërshtuar nenin 510/e të KPC-së.

7.2 Ligji për atribuimin e titullit ekzekutiv të faturës së energjisë elektrike është miratuar me qëllim për t'i ofruar një shërbim sa më të mirë konsumatorëve shqiptarë.

7.3 Ligji kufizon të drejtën për një proces të rregullt ligjor, duke plotësuar dy kriteret e kërkuara nga neni 17 i Kushtetutës, për shkak të një interesi publik dhe duke mos cenuar thelbin e së drejtës, garantuar nga neni 609 i KPC-së.

8. ***Këshilli i Ministrave***, si palë e interesuar, ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, duke parashtruar këto argumente:

8.1 Gjykatat referuese nuk kanë ngritur pretendime të natyrës kushtetuese, por pretendime që kanë lidhje me interpretimin dhe unifikimin e zbatimit të ligjit.

8.2 Ligji për atribuimin e titullit ekzekutiv të faturës së energjisë elektrike është i qartë, i kuptueshëm, pa mangësi të teknikës legjislative dhe, si i tillë, ai nuk cenon sigurinë juridike.

8.3 Kontrata mes "CEZ Shpërndarje" sh.a. dhe konsumatorëve nuk është një marrëdhënie kontraktuale vetëm mes palëve private, duke qenë se CEZ sh.a. mbart mbi vete interes publik, prandaj dhe këto subjekte nuk mund të trajtohen në mënyrë të njëjtë.

9. ***Avokatura e Shtetit***, si palë e interesuar, ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, duke parashtruar këto argumente:

9.1 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier nuk legjitimohet në këtë proces, sepse nuk plotëson kriterin "lidhje e drejtpërdrejtë" mes çështjes në shqyrtim dhe ligjit. Ajo ka pasur për shqyrtim çështjen me objekt pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv, sipas nenit 609 të KPC-së, dhe jo lëshimin e titullit ekzekutiv të faturës së energjisë elektrike.

9.2 CEZ sh.a. është një operator shumë i rëndësishëm në tregun e energjisë elektrike, mbarëvajtja e të cilit, edhe pse shoqëri private, mbart interes publik, si operator i vetëm i licencuar për furnizimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike.

9.3 Përzgjedhja e ligjvënësit, nëpërmjet atribuimit të titullit ekzekutiv faturës së energjisë elektrike, është proporcionale me gjendjen që e ka diktuar atë, që është vështirësia në mbledhjen e detyrimeve të konsumatorëve të energjisë elektrike dhe, për rrjedhojë, dhe ndikimi negativ në cilësinë e ofrimit të shërbimit.

10. "***CEZ Shpërndarje" sh.a.*** si palë e interesuar, ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur këto argumente:

10.1 Të drejtat themelore janë të kufizueshme sipas nenit 17 të Kushtetutës dhe jurisprudencës së GJEDNJ-së. Ligji, i cili parashikon atribuimin si titull ekzekutiv të faturës së energjisë elektrike, është bërë për të mbrojtur një interes publik dhe të drejtat e subjekteve të tjera, nga pasojat që mund të vijnë nga mospagimi në kohë e në mënyrë të plotë i detyrimeve që rrjedhin nga furnizimi me energji elektrike.

10.2 CEZ sh.a. është i detyruar t'ia ofrojë shërbimin të gjithë konsumatorëve tariforë pa përjashtim, pavarësisht vendndodhjes, statusit social apo situatës ekonomike e financiare të tyre. Pamundësia e përzgjedhjes së konsumatorëve shkakton drejtpërdrejt vështirësi në ekzekutimin e detyrimeve mujore të energjisë elektrike.

10.3 Ligji nuk shkel parimin e barazisë, sepse rregullat për ekzekutimin e faturës së energjisë elektrike zbatohen njësoj ndaj të gjithë kategorisë së konsumatorëve. Edhe sikur të kishte cenim, barazia duhet parë e lidhur ngushtë me pozicionin e palëve, që në këtë rast janë në pozita objektivisht të ndryshme.

III

Për legjitimimin e gjykatave referuese

11. Fillimisht Gjykata Kushtetuese (Gjykata) çmon të shprehet në lidhje me legjitimimin e gjykatave referuese, sepse subjektet e interesuara, përkatësisht Kuvendi dhe Avokatura e Shtetit, në prapësimet e tyre kanë dhënë disa argumente për mungesën e lidhjes së drejtpërdrejtë mes ligjit për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës së konsumit të energjisë elektrike, që është çmuar si i papajtueshëm me Kushtetutën, dhe zgjidhjes së çështjes konkrete.

12. Gjykata është shprehur vazhdimisht për aspektet e legjitimimit të gjykatave, të cilat e vënë në lëvizje atë nëpërmjet kontrollit incidental. Sipas saj, gjykata ose gjyqtari i cili kërkon kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjit përpara Gjykatës Kushtetuese, duhet të respektojë disa kritere; *së pari*, gjykata ose gjyqtari, gjatë një procesi gjyqësor, duhet të përcaktojë/identifikojë

ligjin që zbatohet për zgjidhjen e çështjes konkrete; *së dyti*, duhet të parashtrojë arsye serioze për jokushtetutshmërinë e këtij ligji (të një ose të disa dispozitave të ligjit), duke referuar në normat ose parimet konkrete të Kushtetutës; *së treti*, të ketë krijuar bindjen se gjykimi nga gjykata ose gjyqtari nuk mund të përfundojë në mënyrë të pavarur nga gjykimi në Gjykatën Kushtetuese dhe se kjo gjykatë/ky gjyqtar nuk kishte mundësi ta zgjidhte çështjen, edhe pa iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese; *së katërti*, të bëjë të gjitha përpjekjet për ta interpretuar ligjin në përputhje me Kushtetutën (*vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.30, datë 17.06.2010; nr.18, datë 23.04.2010; nr.12, datë 14.04.2010; nr.2, datë 03.02.2010; nr.13, datë 04.05.2009; nr.5, datë 06.03.2009; nr.14, datë 21.07.2008); së pesti,* të argumentojë nëse ka pasur mundësi për interpretim të dispozitës në pajtim me Kushtetutën *(vendimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve nr.142, datë 01.12.2011*).

13. Në mbështetje të këtyre kritereve, Gjykata çmon se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier nuk legjitimohet, pasi çështja e paraqitur për shqyrtim para saj ka pasur për objekt deklarimin e pavlefshmërisë së titujve ekzekutivë, faturat e shitjes së energjisë elektrike, bazuar në nenin 609 të KPC-së, që nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë me objektin e kërkesës para Gjykatës Kushtetuese, (antikushtetutshmëria e ligjit për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës së konsumit të energjisë elektrike).

14. Po në mbështetje të kritereve të lartpërmendura, Gjykata vlerëson se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, *prima facie*, ka shkaqe dhe argumente, të cilat përbëjnë bazën ku mbështeten pretendimet për papajtueshmëri të ligjit me Kushtetutën. Kjo gjykatë, me gjykimin e çështjes civile me objekt lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për titujt ekzekutivë për faturat mujore të papaguara të energjisë elektrike, ka identifikuar normat dhe parimet kushtetuese, të cilat ligji nuk i ka respektuar ose i ka cenuar, si dhe ka argumentuar mjaftueshëm shkaqet për të cilat kërkohet shfuqizimi i ligjit. Për më tepër, kjo gjykatë ka argumentuar se nuk ka pasur mundësi të interpretimit të ligjit në pajtim me Kushtetutën dhe për këtë arsye nuk mund të përdorte mekanizëm tjetër veç atij të kontrollit incidental të ligjit para Gjykatës Kushtetuese. Prandaj dhe Gjykata konkludon se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë legjitimohet, për shkak se ekziston lidhja e drejtpërdrejtë midis zgjidhjes së çështjes konkrete dhe ligjit që kundërshtohet për papajtueshmëri me Kushtetutën.

15. Për rrjedhojë, Gjykata sqaron se më poshtë do të marrë në analizë vetëm pretendimet e ngritura nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë në lidhje me mosrespektimin e kërkesave të nenit 42 dhe 17 të Kushtetutës, me mosrespektimin e parimit të barazisë në ligj sipas nenit 18 të Kushtetutës dhe mosrespektimin e parimit të sigurisë juridike.

IV

A. Për pretendimin për mosrespektimin e kërkesave të nenit 42 dhe 17 të Kushtetutës

16. Sipas gjykatës referuese, nëpërmjet ligjit për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës së konsumit të energjisë elektrike cenohet e drejta e pronësisë e debitorit, por jo nëpërmjet një procesi të rregullt ligjor, të kërkuar nga neni 42 i Kushtetutës, pasi procedura e lëshimit të urdhrit të ekzekutimit nuk përmbush standardet e këtij procesi, duke qenë se është një gjykim vetëm mbi ligjshmërinë e aktit.

17. Po kjo gjykatë pretendon se kriteri "interes publik", në ligjin për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës së konsumit të energjisë elektrike, nuk ekziston, sepse në një marrëdhënie kontraktuale prevalon parimi i autonomisë së vullnetit, që do të thotë se palët me vullnet të lirë marrin përsipër të drejta dhe detyrime, pasojat e të cilave vijnë ekskluzivisht për to dhe për asnjë tjetër.

18. Sipas subjektit të interesuar, Kuvendit, ky ligj kufizon të drejtën për një proces të rregullt ligjor, por duke plotësuar dy kriteret e nenit 17 të Kushtetutës, për shkak të një interesi publik dhe duke mos cenuar thelbin e së drejtës, që është garantuar me nenin 609 të KPC-së. Të njëjtat argumente paraqet dhe subjekti tjetër i interesuar, Avokatura e Shtetit.

19. Neni 42 i Kushtetutës sanksionon se liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa *një proces të rregullt ligjor*. Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetuese dhe ligjore, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

20. Gjykata vlerëson se, duke qenë se e drejta për një proces të rregullt ligjor përbën një nga të drejtat themelore të individit, ajo ka për detyrë të verifikojë ekzistencën e kufizimit, si dhe nëse ky kufizim është bërë sipas kritereve të përcaktuara shprehimisht në Kushtetutë.

21. Gjykata rithekson se për të justifikuar, në pikëpamje të Kushtetutës, prekjen e të drejtave dhe lirive themelore të individit, është e domosdoshme të përmbushen disa kushte, siç janë ato që kufizimi të realizohet me ligj, të jetë bërë për interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve, të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar, si dhe të mos cenojë thelbin e të drejtave dhe të lirive themelore (*vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.10, datë 19.03.2008*).

22. Gjykata ka theksuar se: "…lista e çështjeve me interes publik nuk mund të jetë kurrsesi shteruese, pasi interesi publik duhet kuptuar në sensin relativ, në varësi të situatave të ndryshme që krijohen" (*vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.18, datë 14.05.2003)*.

23. Duke pasur parasysh këto konsiderata të përgjithshme, kjo Gjykatë çmon se furnizimi me energji elektrike, si shërbim me interes të përgjithshëm, meriton vëmendje dhe trajtim të posaçëm nga ligjvënësi, për dy arsye: i) për shkak të situatës monopol të CEZ sh.a., aktualisht; ii) për shkak të specifikës së shërbimit. Vazhdimësia, cilësia dhe aksesueshmëria e këtij shërbimi duhet t'u ofrohet të gjithë konsumatorëve pa përjashtim, sipas kritereve specifike ligjore. Për më tepër, trajtimet specifike ligjore, me synim që të garantohet aksesi i çdo individi në mallrat dhe shërbimet bazë/jetike, janë të domosdoshme, sepse këto shërbime ndikojnë në cilësinë e jetës dhe janë një parakusht për gëzimin e shumë të drejtave të tjera themelore të individit.

24. Për më tepër, Gjykata vlerëson se parimi i shtetit social, i parashikuar që në preambulën e Kushtetutës sonë, e përligj ndërhyrjen e autoritetit publik në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë edhe në marrëdhëniet juridike private, për të mbrojtur interesat e përgjithshëm, si p.sh. kontrolli publik i kostos së jetesës, lufta kundër inflacionit, shtytja dhe nxitja e aktiviteteve prodhuese, mbrojtja e shtresave të varfra, promovimi i vlerave sociale, etj. Është e pamohueshme që në varësi të rrethanave, mund të justifikohet ruajtja nga ana e shtetit e një mase të caktuar ndërhyrjeje në sipërmarrje, të cilat kanë qenë publike dhe më pas janë privatizuar, kur ato operojnë në fusha të shërbimeve me interes publik.

25. Në zbatim të vlerësimeve të mësipërme të saj, Gjykata identifikon si interes publik në ligjin për atribuimin e faturës së energjisë elektrike si titull ekzekutiv, përmirësimin e cilësisë dhe aksesit të këtij shërbimi, si shërbim tepër jetik për të gjithë konsumatorët dhe shoqërinë në tërësi.

26. Gjykata e sheh të arsyeshme që, sa i përket një prej kërkesave të nenit 17/2 të Kushtetutës, që është moscenimi i thelbit të së drejtës nga kufizimi, të ritheksojë se në një çështje të mëparshme, të ngjashme me çështjen në shqyrtim, konkretisht çështjen me objekt papajtueshmërinë me Kushtetutën të "akteve për dhënien e kredive bankare" si tituj ekzekutivë, ajo ka pranuar se procedura për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit edhe nëse eventualisht i cenon ndonjë të drejtë debitorit, kjo e drejtë mund të rivendoset nëpërmjet garantimit të një procesi të rregullt ligjor, bazuar në nenin 609 të KPC-së, pra duke mos u cenuar thelbi i së drejtës (*vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.39, datë 16.10. 2007*).

27. Megjithatë, gjykata referuese pretendon se edhe nëse kufizimi i së drejtës për një proces të rregullt ligjor mund të jetë bërë për mbrojtjen e interesave publikë dhe nuk cenon thelbin e së drejtës, ai nuk është proporcional me gjendjen që e ka diktuar atë.

28. Gjykata çmon ta vlerësojë këtë pretendim nën dritën e testit të proporcionalitetit. Kështu, kushti i proporcionalitetit të ndërhyrjes me gjendjen që e ka diktuar atë (ndërhyrjen), imponon ligjvënësin të aplikojë mjete të tilla ligjore, të cilat duhet të jenë efektive, d.m.th. të

zgjedhura në mënyrë të tillë që të jenë të përshtatshme për realizimin e synimeve që ndiqen. Përdorimi i këtyre mjeteve duhet të jetë i domosdoshëm, gjë që do të thotë se synimi nuk mund të arrihet me mjete të tjera. Domosdoshmëria ka të bëjë gjithashtu edhe me përdorimin e mjeteve më pak të dëmshme për subjektet që u cenohen të drejtat dhe liritë. Kushti i përpjesëtimit të kufizimit me gjendjen që e ka diktuar, konkretizohet në kërkesën e domosdoshmërisë, dobishmërisë dhe proporcionalitetit, në kuptimin strikt të kufizimeve të imponuara. Respektimi i këtyre kushteve kërkon një analizë të kujdesshme në çdo rast konkret, duke ballafaquar interesin publik që dikton kufizimin me ato të drejta që si rezultat i tij i nënshtrohen kufizimit, si dhe duke vlerësuar edhe mënyrën e kufizimit (*vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 16, datë 25.07.2008*).

29. Gjykata vlerëson se në thelb të parimit të proporcionalitetit qëndron "ekuilibrimi i drejtë i interesave", vlerësimi i rëndësishëm dhe objektiv i tyre, si dhe shmangia e konfliktit nëpërmjet përzgjedhjes së mjeteve të duhura për realizimin e tyre. Një kufizim do të konsiderohej në përputhje me standardet e parimit të proporcionalitetit nëse: i) objektivi i ligjvënësit është mjaftueshëm i rëndësishëm për të justifikuar kufizimin e së drejtës; ii) masat e marra janë të lidhura në mënyrë të arsyeshme me objektivin-ato nuk mund të jenë arbitrare, të padrejta, ose të bazuara mbi vlerësime alogjike; iii) mjetet e përdorura nuk janë më të ashpra se sa për të arritur objektivin e kërkuar- sa më të mëdha efektet e dëmshme të masës së përzgjedhur, aq më tepër objektivi për t'u arritur duhet të jetë i rëndësishëm, në mënyrë që masa të justifikohet si e nevojshme (*perifrazim nga çështjet Marper kundër Mbretërisë së Bashkuar, vendim i datës 4 dhjetor 2008, prg.101-104; Coster kundër Mbretërisë së Bashkuar, vendim i datës 18 janar 2001, prg.106-108, 117-118; Faber kundër Hungarisë, vendim i datës 24 korrik 2012, prg. 28-41; Nada kundër Zvicrës, vendim i datës 12 shtator 2012, prg.185 dhe 191*).

30. Duke iu kthyer rastit konkret, në vlerësimin e Gjykatës ligjvënësi ka respektuar ekuilibrin e nevojshëm ndërmjet interesit publik nga njëra anë që synon qëndrueshmërinë e sistemit elektroenergjetik, garantimin për vjeljen e detyrimeve brenda një afati të arsyeshëm e për rrjedhojë përmirësimin e cilësisë dhe të aksesit të këtij shërbimi, si dhe nga ana tjetër garantimit të mbrojtjes ligjore të individit, në rast të abuzimit me faturat e energjisë elektrike. Në legjislacionin mbi sektorin e energjisë elektrike ka parashikime të hollësishme mbi trajtimin dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet të licencuarve dhe konsumatorëve, duke i dhënë Entit Rregullator të Energjisë Elektrike kompetencën e trajtimit administrativ të ankesave të konsumatorëve, në rast të mosmarrëveshjeve mes furnizuesit dhe konsumatorëve. Po në këtë drejtim mund të theksohet dhe detyrimi i aprovimit të "kontratës tip" të furnizimit me energji elektrike ndërmjet konsumatorëve tarifore dhe furnizuesit, nga ERE, institucion i pavarur mbikëqyrës për ruajtjen e ekuilibrave ndërmjet interesave të konsumatorëve, shtetit, investitorëve dhe pjesëmarrësve të tjerë në sektorin e energjisë elektrike. Në këtë kontratë është parashikuar një procedurë e detajuar e verifikimit të ankesave nga furnizuesi, e pezullimit të ekzekutimit të faturës për faturime dukshëm të larta si dhe anulimit tërësisht ose pjesërisht të faturës së energjisë elektrike, në rast se ankimi qëndron, duke garantuar mbrojtje të interesave të konsumatorëve nëpërmjet një procesi administrativ.

31. Në vazhdën e argumenteve të mësipërme, Gjykata rithekson se neni 609 i KPC-së i njeh të drejtën debitorit *"të kërkojë në gjykatën kompetente të vendit të ekzekutimit që të deklarohet se titulli ekzekutiv është i pavlefshëm, ose se detyrimi nuk ekziston, ose ekziston në një masë më të vogël ose është shuar më pas"* (vendimi *i Gjykatës Kushtetuese nr.39, datë 16.10.2007*). Për rrjedhojë, procedura e lëshimit të urdhrit të ekzekutimit, bazuar në ligjin për atribuimin e faturave të energjisë elektrike si titull ekzekutiv, nuk është procedurë e pakthyeshme, sepse debitorit i aksesohet e drejta e ngritjes së kërkesë-padisë në gjykatë, bazuar në nenin 609 të KPC-së, duke iu garantuar një proces gjyqësor i plotë dhe i gjithanshëm, njësoj si me çdo padi themeli.

32. Gjithashtu, Gjykata vëren se metoda e përzgjedhur nga ligjvënësi nëpërmjet cilësimit si titull ekzekutiv të akteve të ndryshme, nuk është zbatuar vetëm në sektorin e energjisë elektrike, por ndeshet dhe në fusha të tjera. Kjo nuk tregon se atribuimi si titull ekzekutiv i faturës së energjisë

elektrike është forma e vetme për të arritur qëllimin e kërkuar, por tregon se ligjvënësi këtë formë të atribuimit si titull ekzekutiv të një akti e ka konceptuar si të domosdoshme dhe efektive, në disa sektorë me problematika sociale, ekonomike apo dhe fushat me interes të përgjithshëm, të cilat e justifikojnë deri në një farë mase ndërhyrjen nga ana e tij. Në rast se procedura e mbledhjes së të ardhurave nga konsumi i energjisë elektrike nuk do të ishte efektive, sistemi energjetik do të kishte pasoja negative jo vetëm mbi konsumatorët debitorë, por edhe konsumatorë të tjerë tepër të rëndësishëm, si spitalet, shkollat, burgjet, etj. Pagimi, në kohë të arsyeshme, i faturës së konsumit të energjisë elektrike nga ana e konsumatorëve tariforë paraqet domosdoshmëri edhe për shkak të mosakumulimit të "borxhit të keq", i cili ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në rritjen e nivelit të tarifës për konsumatorët tariforë të energjisë elektrike.

33. Nën dritën e këtyre konsideratave, Gjykata vlerëson se metoda e përzgjedhur nga ligjvënësi, sipas së cilës fatura e energjisë elektrike përbën titull ekzekutiv, ekuilibron interesat e vëna në diskutim, si dhe është diktuar nga domosdoshmëria dhe efektshmëria për të realizuar shlyerjen e detyrimeve financiare të energjisë elektrike nga konsumatorët, brenda një afati kohor të arsyeshëm. Për rrjedhojë, ky ligj përmbush standardet e kërkuara nga neni 17 i Kushtetutës.

B. Për pretendimin mbi cenimin e barazisë së palëve në kundërshtim me nenin 18 të Kushtetutës

34. Gjykata referuese pretendon se ligji për atribuimin e faturës së energjisë elektrike si titull ekzekutiv, është diskriminues, sepse kontrata mes CEZ sh.a. dhe abonentit është kontratë individuale mes dy subjekteve të barabarta prandaj dhe çdo konflikt duhet zgjidhur me padi themeli në gjykatë. Po sipas kësaj gjykate, neni 510/e i KPC-së konsideron tituj ekzekutivë, vetëm ato akte të cilat i përkasin sferës publike dhe jo akteve të lëshuara nga entitete të organizuara në formë shoqërie tregtare, sikundër është lëshimi i faturës së energjisë elektrike nga CEZ sh.a.

35. Gjykata, nëpërmjet jurisprudencës së saj, në disa vendime ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, duke u shprehur se: "Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllojta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia para ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta" si dhe "Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme e objektive mund të përligjet trajtim i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë". (…) "Barazia në ligj dhe para ligjit kërkon që të gjitha subjektet të trajtohen në mënyrë të njëjtë, por nuk parakupton zgjidhje të njëllojta për individë apo kategori subjektesh të cilët ndodhen në kushte objektivisht të ndryshme" (*vendimi nr.34, datë 20.12.2005; vendimi nr.39, datë 16.10.2007 i Gjykatës Kushtetuese*).

36. Gjykata vlerëson se kontrata e furnizimit me energji elektrike mes dy palëve, njëra me cilësinë e furnizuesit dhe tjetra me cilësinë e blerësit, edhe pse mes dy subjekteve kontraktuale private, nuk sjell vetëm pasoja ndërmjet palëve. Pagimi i detyrimeve kontraktuale financiare ndaj CEZ SHA, për konsumin e energjisë elektrike, ndihmon stabilitetin financiar të kësaj shoqërie dhe, për rrjedhojë, dhe funksionimin sa më të mirë të sistemit elektroenergjetik, i cili për nga rëndësia është jetik për funksionimin normal të shoqërisë. Sipas Gjykatës, sikundër argumentoi dhe më lart, *(supra, prg.25*), kjo kontratë tenton edhe realizimin dhe ndjekjen e një qëllimi publik/interesi të përgjithshëm. Nga kjo pikëpamje, në kontratën e furnizimit me energji elektrike, jemi para subjekteve në pozita objektivisht të ndryshme, prandaj dhe Gjykata çmon se kushtetutshmëria e ligjit nuk duhet kontrolluar në drejtim të cenimit të parimit të barazisë.

C. Për pretendimin mbi cenimin e parimit të sigurisë juridike

37. Gjykata referuese pretendon se ligji vjen në kundërshtim me parimin e shtetit të së drejtës dhe me parimin e sigurisë juridike. Në çështjet civile, me objekt lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për faturat e energjisë elektrike, janë konstatuar praktika të ndryshme të gjykatave, lidhur me faktin se kamatëvonesat janë tituj ekzekutivë, si pjesë përbërëse e faturës së energjisë

elektrike. Kjo situatë vjen si pasojë e paqartësisë dhe mungesës së parashikimeve tekstuale ligjore. Ligjit i mungon përcaktimi i elementeve përbërëse të faturës së energjisë elektrike, si dhe momenti se kur fatura bëhet titull ekzekutiv. Në këtë kontekst, mund të merrnin cilësinë e titullit ekzekutiv dhe detyrime të cilat nuk kanë qenë në qëllimin e ligjvënësit. Një pasojë e tillë do të ishte e rrezikshme për të drejtat e individëve, duke cenuar dhe parimin e sigurisë juridike.

38. Gjykata ka theksuar se në vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjeve, ajo niset nga prezumimi i pajtueshmërisë së tyre me Kushtetutën. Kjo do të thotë se, lidhur me jokushtetutshmërinë e pretenduar, duhet të parashtrohen argumente bindëse, për t'i dhënë mundësi Gjykatës Kushtetuese të vlerësojë nëse zgjidhjet ligjore të zbatuara shkelin normat dhe vlerat kushtetuese (*vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.16, datë 25.07.2008*).

39. Gjykata vlerëson se pretendimet e parashtruara për cenimin e sigurisë juridike nëpërmjet trajtimit të faturës së konsumit të energjisë elektrike si titull ekzekutiv, nuk janë të mjaftueshme për t'i konsideruar në nivel kushtetues.

40. Gjykata, bazuar në analizën në tërësi të pretendimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, arrin në përfundimin se ligji për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës së konsumit të energjisë elektrike, nuk bie në kundërshtim me kërkesat e neneve 42, dhe 17 të Kushtetutës. Për këtë arsye, kërkesa për vlerësimin e ligjit objekt shqyrtimi, si të papajtueshëm me Kushtetutën, është e pabazuar dhe për rrjedhojë duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 145/2 të Kushtetutës dhe nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Xhezair Zaganjori, Vladimir Kristo, Altina Xhoxhaj, Sokol Berberi, Vitore Tusha, Fatmir Hoxha, Admir Thanza.

VENDIM
Nr. 53, datë 5.12.2012

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Anëtar	i Gjykatës	Kushtetuese
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i "	"
Vitore Tusha	Anëtare	e "	"
Sokol Berberi	Anëtar	i "	"
Fatmir Hoxha	Anëtar	i "	"
Admir Thanza	Anëtar	i "	"
Altina Xhoxhaj	Anëtare	e "	"

me sekretare Blerina Basha, në datën 04.10.2012, mori në shqyrtim në seancë plenare me dyer të hapura çështjen nr. 26 Akti, që i përket:

KËRKUES: Agim Molla, Petrit Molla

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi, si të papajtueshëm me Kushtetutën, i vendimeve: nr.59, datë 11.06.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gramsh; nr.30, datë 27.03.2008 të Gjykatës së Apelit Durrës; nr.00-2010-462 (374), datë 23.04.2010 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 31/ç, 37, 41, 42/1/2, 131/f, 132/1, 134/1/g dhe 142/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 24, 27, 28 dhe 30 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë".

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes, Altina Xhoxhaj, kërkuesit që kërkuan pranimin e kërkesës, dhe, pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesit Agim Molla dhe Petrit Molla kanë paraqitur në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan kallëzim penal për shtetasit B.M. dhe S.B., përkatësisht me detyrën e prokurorit dhe oficerit të policisë gjyqësore në këtë prokurori, pasi me veprimet e tyre të kundërligjshme në mbrojtje të shtetasve B.N., M.A., V.ZH., E.K., M.S., Q.Ç., K.K. dhe S.M., kanë konsumuar veprat penale të parashikuara nga nenet 248, 119 dhe 120 të Kodit Penal (KP). Për shtetasit e përmendur në kallëzimin e tyre, kërkuesit kanë pretenduar të ndiqen edhe ata penalisht, për shkak se veprat penale janë konsumuar në kuadrin e një grupi të strukturuar kriminal, në kuptim të nenit 28/4 të KP-së.

2. Me vendimin e datës 28.03.2007, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan ka vendosur moskompetencën për shqyrtimin e këtij kallëzimi dhe kalimin e akteve për kompetencë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gramsh, për arsye se disa nga personat e akuzuar ushtronin përkatësisht detyrën e prokurorit dhe atë të oficerit të policisë gjyqësore pranë asaj prokurorie.

3. Me vendimin nr.223/1, datë 10.04.2007, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gramsh ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, për shkak të vërtetimit të kushteve të parashikuara në nenin 290/1, shkronjat "ç" dhe "e", të Kodit të Procedurës Penale (KPP). Kundër këtij vendimi kërkuesit kanë paraqitur ankim në gjykatë.

4. Me vendimin nr.59, datë 11.06.2007, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gramsh ka vendosur rrëzimin e kërkesës ankimore të paraqitur nga kërkuesit kundër vendimit për mosfillimin e procedimit penal.

5. Me vendimin nr.30, datë 27.03.2008, Gjykata e Apelit Durrës ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr.59, datë 11.06.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gramsh. Kundër këtij vendimi kërkuesit kanë ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë.

6. Me vendimin nr.00-2010-462 (374), datë 23.04.2010, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesit, për shkak se ai nuk është paraqitur në formën e kërkuar nga ligji, pasi mungon nënshkrimi i tij nga mbrojtësi.

7. ***Kërkuesit Agim Molla dhe Petrit Molla*** i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata), duke pretenduar se vendimet gjyqësore të tri shkallëve të gjykimit janë jokushtetuese dhe kërkojnë shfuqizimin e tyre për këto shkaqe:

7.1 Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, duke mos pranuar rekursin e paraqitur, edhe pse i paraqitur brenda afateve ligjore dhe i nënshkruar rregullisht prej kërkuesve, u ka cenuar të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të pasur një përgjigje përfundimtare lidhur me pretendimet e ngritura prej tyre.

7.2 Vendimet gjyqësore të gjykatës së shkallës së parë dhe asaj të apelit janë të paarsyetuara, pasi ato nuk i përmendin fare dhe nuk shprehen lidhur me provat dhe pretendimet e paraqitura nga kërkuesit.

7.3 Gjykata e shkallës së parë ka keqinterpretuar nenin 78 të KPP-së. Po ashtu, në dosjen në gjykim nuk gjendet asnjë akt që të provojë se prokurori ka kryer hetime lidhur me çështjen, ndërkohë që ka pasur një urdhërim të gjykatës jo vetëm për kryerjen e hetimit, por edhe për caktimin e një eksperti të fushës së ndërtimit, detyra këto që nuk janë plotësuar. Shkeljet e kryera nga prokurori nuk janë evidentuar dhe riparuar nga gjykatat që kanë shqyrtuar ankimin e kërkuesve.

7.4 Vendimi i gjykatës së apelit është i gabuar, pasi kallëzimet penale të cilave ajo u referohet janë të ndryshme nga njëra–tjetra; ato nuk u referohen të njëjtëve persona, në ndryshim nga sa arsyeton ajo gjykatë.

II

A. Për pretendimin për cenimin e të drejtës për t'iu drejtuar Gjykatës së Lartë

8. Kërkuesit pretendojnë se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, që ka vendosur mospranimin e rekursit për arsye se nuk përmbante nënshkrimin e mbrojtësit, u ka cenuar të drejtën për t'iu drejtuar asaj gjykate dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare për pretendimet e ngritura para saj.

9. Në jurisprudencën e saj, Gjykata ka theksuar se e drejta e individit për t'iu drejtuar gjykatës, si një nga elementet e procesit të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës evropiane të të drejtave të njeriut (KEDNJ), nuk përfshin vetëm të drejtën për të hapur një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare në lidhje me mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesi në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Mohimi i së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj lidhur me pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr.38, datë 30.12.2010; nr.5, datë 2.03.2011; nr.8, datë 16.03.2011; nr.9, datë 29.03.2011; nr.10, datë 29.03.2011; nr.46, datë 04.11.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Gjykata ka theksuar, megjithatë, se e drejta për t'iu drejtuar një gjykate nuk është absolute. Kjo e drejtë mund të jetë objekt kufizimesh (veçanërisht lidhur me kushtet e pranimit të një apelimi), por këto kufizime nuk duhet të jenë të tilla sa të dëmtojnë vetë thelbin e të drejtës. Në vështrim të garantimit të së drejtës së aksesit në gjykatë, Gjykata ka vlerësuar se neni 435/2 i KPP-së, i cili parashikon *inter alia* se akti i rekursit dhe memoriet duhet të nënshkruhen nga mbrojtësit, me pasojë mospranimin, nuk mund të interpretohet nga Gjykata e Lartë në një mënyrë të tillë që cenon thelbin e të drejtës së një individi për t'iu drejtuar asaj gjykate. Zbatimi i nenit 435/2 të KPP-së, për të garantuar të drejtën e një individi për t'iu drejtuar Gjykatës së Lartë, duhet parë në raport me rregullimet e përgjithshme që disiplinojnë paraqitjen e ankimit (nenet 407- 421 të KPP-së), si dhe ato të veçanta për paraqitjen e rekursit (nenet 431-435 të KPP-së). Në situatën në të cilën kërkuesi ka ushtruar rekursin, në përmbushje të detyrimeve të tij formale që përcaktohen kryesisht në nenet 410, 412, 420, 435/1 të KPP-së, dhe rekursi nuk është nënshkruar nga mbrojtësi i zgjedhur prej tij, ai nuk mund të privohet nga e drejta që rekursi i tij të vlerësohet sipas përcaktimeve të nenit 432 të KPP-së (*shih vendimet nr.38, datë 30.12.2010; nr.10, datë 29.03.2011; nr.26, datë 13.06.2011, nr.41, datë 28.09.2011; nr.22, datë 23.04.2012; nr.29, datë 15.05.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka theksuar se çdo interpretim i ndryshëm, që mund t'i bëhet përmbajtjes së nenit 435/2 të KPP-së, nuk i shërben garantimit të standardeve për një proces të rregullt ligjor, në drejtim të së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës. Referimi i bërë nga Kolegji Penal vetëm në kërkesat e nenit 435/2 të KPP-së, duke mos marrë në konsideratë kërkesat e nenit 432 të KPP-së për shqyrtimin e rekursit, cenon të drejtën e individit për t'iu drejtuar Gjykatës së Lartë (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 8, datë 16.03.2011, nr. 41, datë 28.09.2011*).

11. Rekursi është akti procedural në të cilin parashtrohen shkaqet për të cilat kundërshtohet një vendim, sipas kërkesave të nenit 432 të KPP-së, që mundëson të drejtën e të pandehurit për të filluar gjykimin në Gjykatën e Lartë dhe, në këtë kuptim, ai është akti me të cilin garantohet e drejta për akses në këtë gjykatë. Kërkesa kushtetuese dhe procedurale, për të garantuar mbrojtjen efektive dhe profesionale të të pandehurit në Gjykatën e Lartë, ka kuptim, para së gjithash, në funksion të aksesit që duhet të kenë të pandehurit për të ushtruar të drejtat që parashikon procedura penale (*shih vendimet nr.38, datë 30.12.2010; nr.10, datë 29.03.2011; nr.26, datë 13.06.2011, nr.41, datë 28.09.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata e Lartë, para se të vendosë mospranimin e rekursit për shkak të mosnënshkrimit të tij nga mbrojtësi, duhet të verifikojë nëse sekretaria gjyqësore ka zbatuar detyrimin ligjor lidhur me vënien në dijeni të rekursuesit, për ta plotësuar atë me nënshkrimin e mbrojtësit, sipas kuptimit që Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vendimin unifikues nr.5, datë 15.09.2009, i kanë dhënë nenit 415/2 të KPP-së, ku shprehen se "*sekretaritë e gjykatave ku depozitohet ankimi mund dhe duhet të vënë në dijeni të pandehurit në rastet kur rekursi paraqitet i pa nënshkruar nga mbrojtësi, me qëllim që, në zbatim të kërkesave të nenit 415/2 të KPP-së, ai të ketë mundësinë për plotësimin e tij*". Gjykata thekson, gjithashtu, se përdorimi i mjetit procedural të përshtatshëm ankimues, në formë e në përmbajtje, siç është sanksionuar në KPP, nuk përbën një kërkesë formale, por një kërkesë që lidhet me thelbin e të drejtës së mbrojtjes dhe të pjesëmarrjes aktive në gjykim. Trajtimi i mjetit procedural në mënyrë josubstanciale cenon të drejtën e mbrojtjes të të gjykuarit dhe njëkohësisht aksesin e tij në Gjykatën e Lartë (*shih vendimet nr.38, datë 30.12.2010; nr.26, datë 13.06.2011; nr.41, datë 28.09.2011; nr.22, datë 23.04.2012; nr.29, datë 15.05.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Gjykata vëren se kërkuesit Agim Molla dhe Petrit Molla kanë depozituar brenda afatit ligjor, pranë sekretarisë së gjykatës që ka dhënë vendimin, një rekurs i cili nuk ka qenë i nënshkruar nga një mbrojtës i zgjedhur, por është nënshkruar nga vetë ata. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit për shkak të mosnënshkrimit të tij nga mbrojtësi, sipas kërkesave të nenit 435/2 të KPP-së. Në këndvështrim të garantimit të standardeve të trajtuara më sipër, Gjykata vlerëson se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë e ka interpretuar nenin 435/2 të KPP-së në një mënyrë të tillë (stricto senso) që ka cenuar thelbin e të drejtës së kërkuesve për t'iu drejtuar asaj gjykate. Nga materialet e paraqitura para kësaj Gjykate, nuk rezulton që Kolegji Penal të ketë vlerësuar veprimet e sekretarisë gjyqësore përkatëse për vënien në dijeni të kërkuesve për mosplotësimin e kërkesës formale të nënshkrimit të rekursit nga mbrojtësi, në mënyrë që ata të mund të bënin plotësimet e nevojshme.

13. Për sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, duke vendosur mospranimin e shqyrtimit të rekursit të paraqitur nga kërkuesit, me arsyetimin se nuk ka qenë i nënshkruar nga mbrojtësi, u ka cenuar atyre të drejtën e aksesit në Gjykatën e Lartë, si një nga standardet për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

B. Për pretendimin për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimeve gjyqësore

14. Kërkuesit pretendojnë, gjithashtu, se vendimet gjyqësore nuk janë të arsyetuara, se ato tregojnë vetëm historikun e vendimeve të dhëna nga prokuroritë dhe gjykatat dhe nuk shprehen në asnjë rresht për pretendimet dhe provat konkrete të kërkuesve apo arsyet pse nuk i pranojnë ato.

15. Gjykata rithekson se e drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga neni 42, 142/1 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar si dhe u jep mundësinë atyre ta apelojnë këtë vendim, si dhe organeve të apelit ta shqyrtojnë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë (*shih vendimet nr.7, datë 09.03.2009; nr.38, datë 30.12.2010; nr.8, datë 16.03.2011; nr.25. datë 10.06.2011; nr.8, datë 28.02.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Në kuptim të sa më sipër, gjykatat duhet të parashtrojnë, në mënyrë të përmbledhur, rrethanat e faktit, provat mbi të cilat bazohet vendimi, mënyrën e vlerësimit të këtyre provave, pra të tregojnë me qartësi të mjaftueshme arsyet mbi të cilat mbështesin vendimet e tyre. Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve, në përfundim të gjykimit, përbëjnë aktin procedural kryesor të gjithë procesit gjyqësor. Ato përmbledhin dhe finalizojnë përfundimisht qëndrimet që mban gjykata lidhur me çështjen në gjykim. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion, të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë gjithashtu të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Konkluzionet e pjesës arsyetuese duhet të bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik (*shih vendimet nr.33, datë 08.12.2005; nr.23, datë 04.11.2008; nr.36, datë 26.07.2011; nr.8, datë 28.02.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Bazuar në këto standarde kushtetuese dhe në rrethanat e çështjes, Gjykata vlerëson se nuk rezulton që vendimet e kundërshtuara të jenë jologjike, të kenë kundërthënie, të mos kenë referencë në ligjin e zbatueshëm dhe të mos respektojnë elementet e përmendura më sipër. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesve, në drejtim të cenimit të standardit kushtetues të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, është i pabazuar.

C. Për pretendimet e tjera të ngritura në kërkesë

18. Gjykata vëren se kërkuesit kanë ngritur edhe pretendime të tjera, siç janë ato lidhur me keqinterpretimin e ligjit, moskryerjen e veprimeve hetimore, se kallëzimet penale të cilave u referohet gjykata e apelit janë të ndryshme etj.

19. Gjykata ka theksuar se kontrolli kushtetues që ajo ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Në lidhje me këto pretendime, Gjykata vlerëson se, në thelb, ato kanë të bëjnë me çështje që lidhen me mënyrën e vlerësimit dhe interpretimit të ligjit nga gjykatat e zakonshme. Kërkuesit nuk kanë arritur t'i ngrenë këto pretendime në nivel kushtetues, duke mos arritur të argumentojnë se cilat elemente të procesit të rregullt janë cenuar. Si të tilla, këto pretendime nuk hyjnë në juridiksionin kushtetues dhe nuk mund të merren në shqyrtim prej Gjykatës.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja "f" dhe nenit 134, pika 1, shkronja "g" të Kushtetutës, si dhe të neneve 72, 77 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës.
- Shfuqizimin e vendimit nr.00-2010-462 (374), datë 23.04.2010 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe kthimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.
- Rrëzimin e kërkesës për pretendimet e tjera.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Xhezair Zaganjori, Vladimir Kristo, Fatmir Hoxha, Sokol Berberi, Admir Thanza

Anëtarë kundër: Vitore Tusha, Altina Xhoxhaj

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QBZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 17.12.2012
Doli nga shtypi më 18.12.2012

Tirazhi: 1200	Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 42 lekë